



KONTROLI I LARTË I SHTETIT

Projekt Raport për auditimin e ushtruar në "Bashkinë Fushë Arrëz"

PROJEKT RAPORT AUDITIMI

MBI

(Auditimin Financiar)

"BASHKIA FUSHË ARRËZ"

Tiranë, Korrik 2024

PËRMBAJTTJA

I. Përmbledhje ekzekutive	4
1.1 Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit	6
II. Hyrja	6
1. Objektivat e auditimit	7
2. Qëllimi i auditimit	7
3. Identifikimi i çështjes	8
4. Përgjegjësi të strukturave drejtuese	8
5. Përgjegjësi të audituesve	8
6. Kriteret e vlerësimit	9
7. Standardet e auditimit	9
8. Metodologjia e auditimit	9
9. Dokumentimi i auditimit	9
III. REZULTATET E AUDITIMIT	10
3.1 Mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit	10
3.1.6 Vlerësimi dhe mbledhjes së të ardhurave	18
3.3 Mbi vlerësimin e raportimit financiar, plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike- Asetet	21
3.7 Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme	38
IV. GJETJE DHE REKOMANDIME	50
ANEKSET	56
VI. LISTA E DOKUMENTEVE TË AUDITIMIT	58

II. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin

Kontrolli i Lartë i Shtetit (këtu e në vazhdim KI.SID) ushtron auditim financiar në Bashkinë Fushë Arrëz, duke i kushtuar vëmendjeve e pasqyrave çështjeve që lidhen me vlerësimin e implementimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit, transaksioneve financiare dhe ngjarjeve ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar si dhe zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

Gjatë periudhës së auditimit nga data 13.05.2024 deri në datën 07.06.2024 u krye auditimi, i cili kishte objekt: "Auditimi financiar të Bashkisë Fushë Arrëz" dhe mbuloi periudhën nga data 01.01.2023 deri në datë 31.12.2023.

Në përfundim të auditimit, mbi bazën e të dhënave të grumbulluara, janë mbajtur gjithsej 4 akt-konstatime dhe 1 akt-verifikim.

b. Rëndësia e institucionit dhe auditimit të tij.

Auditimi i këtij institucioni çdo vit është detyrim ligjor në bazë të ligjit nr. 68/2017 datë 27.04.2017 "Për financat e qeverisjes vendore" nënk. 50 "Auditimi i jashtëm" pikat 1 dhe 2 në të cilat përcaktohet: "1. Veprimtaria financiare dhe zbatimi i buxhetit vjetor të njësisë të vetëqeverisjes vendore u nënshtrohen çdo vit auditimit të jashtëm. 2. Auditimi i jashtëm realizohet nga Kontrolli i Lartë i Shtetit ose auditues të tjerë ligjorë". Gjithashtu ky auditim me rëndësi të veçantë për arsyen se Bashkia Fushë Arrëz si çdo njësi vendore administrative, menaxhon dhe shpenzon fonde publike, pjesë e buxhetit të Bashkisë të miratuar nga Këshilli Bashkiak me burim financiarimi nga të ardhurat e realizuara nga taksupaguesit qytetarë dhe fondet e transformuara nga Buxheti i Shtetit.

c. Qëllimi i auditimit

Qëllimi i këtij auditimi është dhënia e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe mbi përpqutshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare me aktet ligjore dhe nënligjore, për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023. Për të gjitha problematikat e konstatuara janë dhënë rekomandime për përmirësimet me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga Bashkia Fushë Arrëz. Në përmbushje të qëllimit të auditimit, janë shqyrtuar çështjet e mëposhtme:

- mbi menaxhimin financiar, kontrollin dhe auditin e brendshëm
- mbi planifikimin, zbatimin e monitorimin e planit të buxhetit
- mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

d. Metodologjia e përdorur dhe metodat e mbledhjes dhe analizimit të të dhënave.

Metodologjia e përdorur për kryerjen e këtij auditimi është mikse, sistore dhe cilësore. Auditimi është kryer mbi bazë risku. Grupi i auditimit ka audituar mbi 50% të transaksioneve të likuidimeve nëpërmjet bankës dhe auditimin e blerjeve dhe investimeve për procedurat, ku vlera e investimit apo e blerjes është e konsiderueshme. Metodatat e auditimit janë bazuar tek kombinimi i testeve të ndryshme të auditimit. Në varësi të çështjeve të auditimit dhe vlerësimit të audituesve, janë përdorur veçmas ose të kombinuara metodat dhe teknikat e mëposhtme verifikimi i transaksioneve, shqyrtimi i raporteve dhe dokumentacionit, intervistat, verifikimi në sistem dhe terren.

e. Nga shqyrtimi i evidencave, rezultoi se institucioni për periudhën nënauditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve veprimtarisë. Grupi i auditimit ka konstatuar 12 gjetje dhe ka dhënë 12 rekomandime, nga ku masa organizative me 9 gjetje dhe 9 rekomandime një gjetje në fushën e shpenzimeve pa efektivitet si dhe 2 gjetje-rekomandime në vlerën 23,439 mijë lekë në fushën e të ardhurave.

f. Paraqitja e gjetjeve kryesore. Disa nga problematikat e konstatuara lidhen me:

- Procedurat e planifikimit dhe realizimit të të ardhurave

Lista e shkurtimeve

KLSH	Kontrolli i Lartë i Shtetit
MFE	Ministria e Financave dhe Ekonomisë
MFK	Menaxhimi Financiar dhe Kontrolli
NA	Nëpunës Autorizues
NZ	Nëpunës Zbatues
GSM	Grupi i Menaxhimit Strategjik
NJAB	Njësi e Auditimit të Brendshëm
AB	Auditi i Brendshëm
MAB	Manuali i Auditimit të Brendshëm
FZHR	Fondi i Zhvillimit të Rejoneve
AQT	Aktive të Qëndrueshme të Grupëzuara
UMF	Udhëzim i Ministrisë së Financave
VKM	Vendim i Këshillit të Ministrave
VKB	Vendim i Këshillit Bashkiak
ASHK	Agjencia Shtetërore e Kudastrës
NJA	Njësi Administrative
SJA	Shqëri Anonime
NJP	Njësi e Prokurimit
BOR	Bashkim i Operatorëve Ekonomikë
OE	Operator Ekonomik
KVO	Komisioni i Vlerësimit të Ofertave
ISSAI	Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit
INTOSAI	Organizata Ndërkombëtare e Institucioneve Supreme të Auditimit
IFAC	Federata Ndërkombëtare e Kontabilistëve
IPSAS	Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit në Sektorin Publik

- Të ardhura të munguara në vlerën **28,439 mijë lekë** nga mosarkëtimi i taksave dhe tarifave vendore nga debitorë e biznesit dhe institucioneve.

▪ **Procedurat e ndjekura për inventarizimin dhe rregjistrimin e aseteve**

Nga auditimi rezultoi se, Bashkinë Fushë-Arrëz, përfshirë ish-komunat aktualisht njësi administrative, nuk ka miratuar listën përfundimtare të pasurive të paluajtshme. Konkretisht, për Bashkinë Fushë-Arrëz është miratuar lista paraprake e inventarit të pronave, me qëllim afishimin e tyre dhe përditësimin e ndryshimeve në listën përfundimtare të pronave, ndërsa ish-komunat, aktualisht njësi administrative nuk kanë as inventar paraprak. Në këtë inventar të hartuar nga Bashkia Fushë-Arrëz nuk janë përcaktuar zonat kadastrale dhe numrat e pasurive për identifikimin e pronave. Për rrjedhojë, inventarët e pronave të paluajtshme nuk përfaqësojnë një pasqyrë reale të gjendjes faktike të këtyre pasurive, për shkak se nga ana e Bashkisë Fushë-Arrëz nuk është rakorduar me Drejtorinë Vendore të ASHK-së mbi statusin juridik dhe tjetërsimin e mundshëm të pronave nga persona të tretë, përmes procedurave të legalizimit, privatizimit, vendimet e kthimit/kompensimit apo vendimet gjyqësore.

g. Paraqitja e rekomandimeve kryesore:

-Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz të marrë të gjitha masat e menjëhershme për të kryer procesin e plotë të inventarizimit dhe përditësimit të pronave/pyjeve/kullotave si vijon:

- Në bashkëpunim me Drejtorinë e Burimeve Njerëzore të marrë masa për emërimin e një personi ekspert të fushës, që të merret me Menaxhimin e Aseteve, verifikimin dhe përditësimin e të gjitha pronave që ka Bashkia dhe NJA të transferuara në favor të tyre me VKM, duke përcaktuar dhe detyrat konkrete në rregulloren e brendshme të Bashkisë Fushë Arrëz, për të bërë të mundur miradministrimin e pronave.

-Bashkia Fushë Arrëz në lidhje me të ardhurat, të marrë masa dhe të ndjekë të gjitha procedurat administrative dhe ligjore për arkëtimin e detyrimeve për taksat dhe tarifave vendore në vlerën **28,439 mijë lekë** nga taksapaguesit të biznesit, institucione shtetërore, fermerë, individë etj.

- Zyra e Shërbimeve Publike të marrë masa për pajisjen me autorizimet përkatëse të të gjithë subjekteve që operojnë në fushën e tregtimit të hidrokarbureve dhe pas plotësimit të dosjeve përkatëse me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, të rakordojë me zyrën e Taksave dhe të Ardhurave Vendore për përlllogaritjen dhe vjeljen e detyrimeve nga pajisja me autorizime për 3 subjektet.

I.1. Konkluzioni dhe Opinioni i auditimit

A. OPINIONI I AUDITIMIT

I.Opinion i mbi pasqyrat financiare të vitit 2023

a.-Opinion i pamodifikuar, me "Theksim çështjeje"¹:

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të Bashkisë Fushë Arrëz, për vitin ushtrimor 2023, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese. Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Opinion i:

¹ *Opinion i pamodifikuar me theksim çështjeje.* Në rrethanat të caktuara, audituesi mund të marrë në konsideratë faktin se lexuesi nuk do të arrijë në kuptimin e saktë të pasqyrave financiare nëse atij nuk do t'i tërhiqet vëmendja mbi çështjet të prezaktuara ose të rëndësishme. Si parim i përgjithshëm, audituesi nuk i referohet aspekteve specifike të pasqyrave financiare kur jep një opinion të pamodifikuar, në rast se kjo ndodhë mund të kuptohet si modifikim. Për të evituar abuzin e kësaj përcaktjeje të gabuar, referencat e menduara si "theksimi i çështjes" përfshihen në një paragraf të veçantë nga ai i opinionit.

Sipas mendimit tonë, mbështetur në standardet ISSAI 1705¹, dhe ISSAI 1200², pasqyrat financiare veprimet përgjatë raportimit financiar dhe transaksionet e kryera për ekzekutimin e buxhetit janë në përputhje me ligjin për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare, si dhe me ligjet dhe rregullat përkatëse të financave publike, përfshirë rregullat për prokurimet dhe ato të buxhetit. Për përmirësimin e mëtejshëm të gjendjes janë adresuar disa çështje të cilat paraqiten te paragrafi "Thëksimi i Çështjes".

Baza për opinionin e pamodifikuar, me Thëksim çështjeje:

Në e kryem auditimin në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona, sipas këtyre standardeve janë përkrahur në mënyrë më të detajuar në seksionin e raportit, ku jepen Përgjegjësitë e Audituesit për Pasqyrat Financiare. Ne jemi të pavarur nga Bashkia Fushë Arrez, sipas kërkesave etike që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike, në përputhje me këto kërkesa. Ne besojmë se, evidencat e auditimit që kemi siguruar, është e mjaftueshme dhe e përshtrueshme për të marrë siguri të arsyeshme, si dhe për të hazuar dhënien e opinionit tonë. (ISA 700). Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e mara gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtrueshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të pamodifikuar të auditimit. Në dhënien e opinionit, ne kemi marrë në konsideratë vlerën e materialitetit si dhe anomaliat e konstatuara, si vijon:

Thëksimi i çështjeve:

- Llogaria 466 "Kreditorë për mjete nën majte" është pasqyruar në shumë për vlerën 9.194.316 lekë.
- Llogaria 211 "Pyje, Plantacione" paraqitet në vlerën neto prej 5,088,456 lekë. Nga analiza e llogaris rezultoi se nuk është paraqitur vlera e 394 pronave me sipërfaqe 65.287,847 m² pyje e kullota, të cilat janë regjistruar në ish-ZVRPT Dukë, të evidencuara nga zyra e pyjeve e kullotave të bashkisë, të regjistruara në vitet 2012-2013 nga ish bashkia Fushë Arrez dhe ish Komuna Qaf Mali.

1. HYRJA

Mbështetur në ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit" dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 623/1 Prot. date 09.05.2024, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 13.05.2024 deri në datën 07.06.2024, në subjektin Bashkia Fushë Arrez u krye "Auditimi Financiar" për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023.

Grupi i auditimit përbëhej nga audituesit:

- 1.Herman Imerezj – Përgjegjës Grupi
- 2.Shkelzen Huxha – Anëtar
- 3.Redj Ahmetllari – Anëtar

1. Objektivat e auditimit

Auditimi Financiar dhe i Përpëthshëmërisë në Bashkinë Fushë Arrez kishte si objektiva kryesore:

- Vlerësimin nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacionet janë në të gjitha aspektet materiale ose jo, në përputhje me kuadrin ligjer e rregullator mbi bazën e të cilit subjekti që auditohet ushtron veprimtarinë e tij;

¹ Objektivat e auditimit dhe kriteret për vlerësimin e tyre bazohen në ligjin për funksionimin e kontrollit të lartë të shtetit dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 623/1 Prot. date 09.05.2024, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 13.05.2024 deri në datën 07.06.2024, në subjektin Bashkia Fushë Arrez u krye "Auditimi Financiar" për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023.

² Objektivat e auditimit dhe kriteret për vlerësimin e tyre bazohen në ligjin për funksionimin e kontrollit të lartë të shtetit dhe në zbatim të Programit të Auditimit nr. 623/1 Prot. date 09.05.2024, miratuar nga Kryetari i KLSH-së, nga data 13.05.2024 deri në datën 07.06.2024, në subjektin Bashkia Fushë Arrez u krye "Auditimi Financiar" për periudhën 01.01.2023 - 31.12.2023.

- Vlerësimin e zbatimit të kuartrit ligjor në fuqi, duke vlerësuar risqet e anormaleve materiale në pasqyrat financiare dhe nivelin e pohimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedistit të saj, duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjegjëve kundrejt risqeve të vlerësuara dhe gabimeve materiale (ISSAI 1315)¹;
- Dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare dhe procedurat e prokurimit duke kryer vlerësimin e risqeve, nivelin e materialitetit dhe identifikimin të gabimeve, bazuar në standardet ISSAI 700;
- Dhënien e opinionit dhe hartimin e Raportit të Auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënien e rekomandimeve për përmirësim, mhështetur mbi evidencat të besueshme, të njaltueshme dhe përkatëse.

2. Qëllimi i auditimit

Objekti i auditimit financiar në Bashkinë Fushë Arrëz është dhënia e opinionit me siguri të arsyeshme, për periudhën nën auditim, mbi transaksionet financiare dhe ngjarjet ekonomike nëse janë raportuar drejt dhe saktë në pasqyrat financiare të subjektit të audituar. Kjo referuar kuartrit ligjor të raportimit financiar në fuqi. Ndërsa në auditimin e përputhshmërisë synohet dhënia e një vlerësimi objektiv, profesional e të parave, mbi shkallën e ndjekjes nga subjekti i audituar të rregullave, ligjeve, politikave, kodeve të vendosura apo termave, prokurimin e mallrave/shërbimeve dhe investimeve.

3. Identifikimi i çështjes

Projekt Raporti i Auditimit synon të identifikojë përmbushjen e rolit të strukturave të Bashkisë Fushë Arrëz dhe përgjegjësisë, që buron nga kuartri ligjor dhe dispozitat në fuqi, për përmirësimin e vazhdueshëm të punëve në shërbimin të komunitetit, në funksion të zbatimit të strategjive që orientojnë zhvillimin e Bashkisë, si dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit ndaj komunitetit në plotësimin e kërkesave të tyre.

Çështjet mbi të cilat është shtrirë auditimi:

1. Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit - burimi i krijimit të të ardhurave, vlerësimi i mbledhjes së tyre.
2. Vlerësimi i raportimit financiar për vitin 2023.
3. Mbi zbatimin e rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese

Strukturat drejtuese të Bashkisë Fushë Arrëz, janë përgjegjëse për paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në përputhje me në përputhje me kuartrin rregullator të zbatueshëm të raportimit financiar në sektorin publik. Ato janë përgjegjëse për aktivitetin financiar, në përputhje me kriteret e përputhshmërisë duke përfshirë, por pa u kufizuar në ligjin e buxhetit dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe aktet nënligjore në zbatim të tij, ligjin për auditin e brendshëm dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

5. Përgjegjësitë e audituesve

Përgjegjësia e grupit të auditimit është që të shprehë një opinion në lidhje me pasqyrat financiare në zbatim të akteve ligjore dhe nënligjore. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit ISSAI, të cilat kërkojnë që zudhuesi të respektojë kërkesat etike, të përfshijë dhe të kryejë auditimin me qëllim arritjen e një sigurie të arsyeshme në dhënien e opinionit, mhështetur në evidencat e grumbulluara të auditimit. Siguria e arsyeshme i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë siguri absolute. Auditimi në pajtueshmëri (apo në përputhje) me standardet nuk presupozohet që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston.

¹Në zbatim të përcaktimeve të Manuarit të Auditimit Financiar të KLSH-së.

6. Kriteret e vlerësimit

Grupi i auditimit për të vlerësuar aktivitetin e Bashkisë Fushë Arrëz është mbështetur në kuadrin ligjor, nënligjor dhe rregullativ të listuar më poshtë. Ky kuadër ligjor ka shërhyer si bazë për hartimin e kriterëve që ka hartuar grupi i auditimit kundrejt të cilave janë vlerësuar aktivitetet e Bashkisë Fushë Arrëz. Hartimet e kriterëve të vlerësimit janë:

- Ligji organik i KLSH²⁶ nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit";
- Ligji nr. 139/2015 dt. 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore";
- Ligji nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore";
- Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar;
- Ligji nr. 9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e Sistemit Buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar;
- Ligji nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për Sistemin e Taksave Vendore" i ndryshuar;
- Ligji Nr. 88/2019, datë 18.12.2019 "Për buxhetin e vitit 2020";
- VKM nr. 783, datë 22.11.2006 "Për përcaktimin e standardeve dhe të rregullave kontabël";
- "VKM nr. 187, datë 8.3.2017 për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, Zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve, në Kryeministri, aparatet e ministrave të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Gjykatën e Lartë, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të Kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e Prefektit", i ndryshuar;
- VKM nr. 970, datë 2.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënien e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj";
- VKM nr. 860, datë 10.12.2014 "Për përcaktimin e mënyrës së mbledhjes dhe administrimit të të ardhurave për ndërtimet pa leje dhe vlerave të zbatueshme për lupulizim;
- Udhëzimi i MFI nr. 9, datë 27.12.2014 "Për shlyerjen e detyrimeve të prapambetura";
- Udhëzimi i MFI nr. 10, datë 28.02.2020 "Për përgatitjen e PFA vendar 2021-2023";
- Udhëzimi MFI nr. 21, datë 25.10.2016 "Për nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve";
- Udhëzimin i MFI nr. 22, datë 30.07.2018 "Për procedurat standarde të monitorimit të buxhetit të Njësive të Vetëqeverisjes Vendore";
- LMF nr. 30, datë 27.12.2011, "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar;
- Udhëzimi i MF nr. 08, datë 09.03.2018 "Për procedurën e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore të njësive të Qeverisjes së Përgjithshme".
- Rg.

7. Standardet e auditimit

Për kryerjen e Auditimit Financiar në Bashkinë Fushë Arrëz grupi i auditimit ka ndjekur edhe standardet ndërkombëtare të auditimit si më poshtë :

- ISSAI 100 "Parimet themelore të auditimit të sektorit publik",
- ISSAI 200 "Parimet themelore të auditimit financiar",
- ISSAI 2200-2899 "Standardet e auditimit financiar",
- Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA) të Federatës Ndërkombëtare të kontablisteve IFAC.

8. Metodologjia e auditimit

1. Kontrolli aritmetik.

Duke konsideruar faktin se kontabiliteti konsiston në thelb në regjistrimin e fakteve në një formë numerike, si dhe në paraqitjen sintetike të tyre, por mësisë regjistrimit fillestar të fakteve dhe paraqitjes së tyre në formë statetike, që janë edhe qëllimi i tij, bëhen një seri veprimesh që kanë të bëjnë me evidentimin në llogari, mbajtjet, klasifikimin dhe rigrupimin. Kontrolli aritmetik u krye me qëllim që të sigurohet nëse veprimet e llogaritjes dhe të hedhjeve në llogarite përkatëse, që përfundojnë ato nxjerrjen e gjendjeve sintetike, nuk përmbajnë asnjë gabim.

2. Kontrolli me anë të pjesëve justifikuese.

Edhe pse kontabilizimet nuk përmbajnë gabime aritmetike, ato mund të jenë të gabuara, nëse regjistrimet e bëra nuk korrespondojnë me rezultatit.

3. Inspektimi fizik dhe kontrolli i gjendjeve ekzistuese.

Konsistoi në ekzaminimin e aktiveve, të llogarive, të librave kontabël etj. Kontrolli kontabël i ushtruar ekzaktoi përputhjen ndërmjet regjistrimit kontabël dhe pjesëve justifikuese përkatëse. Gjithashtu, u krye marrëveshje e magazinës për të verifikuar kryerjen e saktë të inventarizimit fizik dhe përputhjet e tij me atë kontabël.

4. Kontrolli i vlerësimit.

Kontrolli i vlerësimeve përcaktoi nëse vlerat që u atribuohen gjendjeve ekzistuese janë të sakta, nëse pasuritë duhet të qëndrojnë në bilanc me vlerat që u janë vendosur atyre.

5. Konfirmimi nga të tretët.

Transaksionet e për zgjedhura për t'ju nënshtruar testeve të datave, u kryqëzuan me informacionin e gjeneruar nga llogaritja dhe rakordimet periodike me ente dhe institucione të tjera shtetërore.

6. Kontrolli sipas një treguesi.

Përdorimi i treguesve statistikore me qëllim që të kërkojen fakte ose të dhëna "jashtë normale", që përbëjnë tregues të parregullsisve kontabël. Mund të përmendim nëse ka mangësi e pjesëve justifikuese, gabimet e shpeshta në datat, numrat, referencat e brendshme, regjistrime pak të lexueshme, shifra të renditura keq, korrigjime të shuanta të shifrave, etj.

7. Intervistimi

U krye intervista me specialistët e Bashkisë Fushë Arrëz me qëllim për të kuptuar dhe vlerësuar më mirë problematikat e konstatuara.

8. Raportje dhe Informacione

U shqyrtuan raporte, informacione dhe dokumentacion lidhur me çështjet nën auditim.

Praktikat e ndjekura në kryerjen e auditimit

Mbështetur në standardet ISSAI, audituesit duhet të identifikojnë dhe vlerësojnë risqet e anormale materiale në pasqyrat financiare si dhe nivelet e pëhimeve, nëpërmjet të kuptuarit të njësisë dhe mjedisit të saj, duke përfshirë kontrollin e brendshëm të njësisë dhe duke krijuar kështu bazën për hartimin dhe implementimin e përgjigjeve kundrejt risqeve të vlerësuara të gabimeve materiale¹. Sa në lidhje me grupin e auditimit realizoi vlerësimin e materialitetit në përputhje me ISSAI 1320 dhe ISSAI 1450, duke përcaktuar nivelin e gabimit që audituesi konsideron të mundshëm për të influencuar të përdoruesit e pasqyrave financiare. Nisur nga gjykimin profesional i audituesit dhe ndjeshmëria e zonave të llogaritjes, grupi i auditimit përcaktoi materialitetin në masën 2% për të gjitha zonat e llogaritjes të planifikuara për t'u audituar, ku si bazë për përllogaritjen e materialitetit janë marrë shpenzimet për paga, shpenzime operative dhe investime.

Pas përcaktimit të nivelit të materialitetit, grupi i auditimit ka kryer vlerësimin e sistemeve të kontrollit të brendshëm në institucion sa i takon: (a) hartimit; (b) implementimit; dhe (c) funksionimit të 5-të komponentëve të kontrollit të brendshëm.

Metodologjia e aplikuar gjatë planifikimit konsiston në auditimin e të dhënave të siguruara nga vetë subjekti. Keni ndërmarrë procedurat për vlerësimin e riskut (analiza), me qëllim sigurimin e nivelit të kërkuar të njohjes së riskut të brendshëm dhe riskut të kontrollit të subjektit. Informacion

¹ ISSAI 1315

të vlefshëm administruam dhe nga procedurat e ndjekura nga vetë subjektë për vlerësimin e riskut, duke ia nënshtuar skepticizmit profesional nga ana e audituesve. Çfjhtë vlerësimeve u mbështetën në Modelin e Riskut që KLSH⁶ aplikon⁶.

Nisur sa më sipër, jemi përpjekur të ruajmë nivelin e pranuar të Riskut të Auditimit prej 5%, duke shtuar nivelin e procedurave analitike (ISSAI 1520) dhe testeve thelbësore të kryera. Në këtë kontekst procedurat e ndjekura nga grupi i auditimit konsistojnë në *analiza* të marrëdhënieve mes informacionit financiar dhe jo financiar; *inspektimeve* që konsistojnë në regjistrimin e dokumenteve në regjistrat ditashtë partikarë, ose në fajtë elektronike por edhe inspektime fizike; *observimet* që konsistojnë në analizën e proceseve ose procedurave të kryera nga të tjerë, me qëllim sigurimin e informacionit rreth performancës së proceseve/procedurave, por kjo mbetet e imituar deri në kohën kur observimi ka ndodhur, dhe se *fundi kërkimshetimi* që konsiston në kërkimin e informacionit të personat kompetent dhe të mirëinformuar brenda dhe/ose jashtë njësisë shpenzuese.

9. Dokumentimi i auditimit

Nga audituesit u përgatit dokumentacioni i auditimit, i konsideruar si i njafueshëm për të përdësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit, kryer në përputhje me standardet përkatëse dhe kërkuesat e zbatueshme ligjore dhe rregullatore, rezultatet e këtyre procedurave dhe evidencat e marra të auditimit, si dhe qëshije të rëndësishme, që dallojnë gjatë auditimit, janë reflektuar në përfundimet e arritura në drejtim të tyre dhe gjykimet profesionale në arritjen e këtyre konkluzioneve. Ky dokumentacion është i përshatshëm dhe i rëndësishëm për të konfirmuar dhe mbështetur opinioonet dhe raportin e audituesve dhe shërben si një burim informacioni për përgatitjen e tyre.

III. Përshkrimi i auditimit sipas drejtiveve të auditimit:

1. Mbi planifikimin, zbatimin dhe monitorimin e planit të buxhetit.

Mbi planifikimin dhe zbatimin e planit të buxhetit.

1.1. Programimi PPA dhe programimi i buxhetit vjetor 2023.

1.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kontrolli i realizimit të shpenzimeve huzuar në nivelin e fonde të çelura.

1.3. Auditimi mbi saktësinë e realizimit të tregjeve buxhetore dhe pasqyrimi në raportet e monitorimit.

1.4. Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i futurave të politikujdhura, vendimet gjyqësore, vendimet e shprehësimeve; (Faturat e politikujdhura të shogërohen me liste analitike, të detajuar me numër fature dhe date krijimi etj, sipas raportimit në MBE, ku të evidentohet detyrimi nga mungesa e burimeve të veta dhe detyrimet nga mungesa e alokimit të granteve si FZIR, Ministrinë e linjes etj.).

1.5. Çelja dhe ekzekutimi i fondeve të përfuturra përmes FZIR, saktësia e raportimit buxhetor të tyre;

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet :

1.1. Programimi PPA dhe programimi i buxhetit vjetor për vitin 2023:

⁶ Risku i Auditimit = Risku i qendrësishëm + Risku i kontrolit + Risku i Zbulimit

Të dhënat për PBA dhe projekt buxhetet për vitin 2023 sipas tabelave në vijim:

	Emërtimi	Buxheti Faktik 2022	Paga e I PBA 2023	Paga e II PBA 2023	Projekti I buxhet 2023
600	Paga	119,948	140,194	147,799	147,799
601	Sigurime Shëndetësore	19,176	23,120	24,528	24,528
602	Mallë dhe Shërbime të Tjera	38,342	45,146	43,773	43,773
603	Transferita Korrente të Hija			0	0
606	Trans. për llog. Fara & le-levë	110,331	111,091	112,935	112,935
I	Shpenzime Korrente	241,897	319,851	329,039	329,019
230	Kapitale të Përdorueshme			500	500
231	Kapitale të Trajtuara	18,422	222	10,620	10,620
239	Shp. Kapitale me financa të brendshme	18,422	222	10,620	10,620
239	Kapitale të Përdorueshme				
3I	Shpenzime Kapitalë për Financim të jasht				
3I	Shpenzime Kapitalë	18,422	222	10,620	10,620
III	Shpenzime nga të ardhurat jashtë limitit				
I+II+III	Totali i Shpenzimeve	260,319	320,073	339,659	339,639

Bazimi: Drejtoria e financës

Në formë table paraqitet planifikimi bazë i buxhetit për vitin 2023 dhe ndryshimet në tabelën vijuese:

Niveli	Emërtimi	Buxheti i planifikimit bazë (Viti 2023)						
		(I)	(II)	(III)	(IV)	(V)	(VI+VII+VIII)	
Act		Faktik I vitit planifikimit Viti 2022	PBA Paga e I 2023	Buxheti vijtor Paga e II Viti 2023	Buxheti vijtor Plan I Rishikuar Viti 2023	Faktik I vitit planifikimit 2023	Diferencial	% e realizimit
600	Paga	119,948	140,194	147,799	147,799	147,799	2,310	92%
601	Sigurime Shëndetësore	19,176	23,120	24,528	24,528	24,528	5,142	81%
600+61	Paga - Sigurime	134,124	163,314	172,327	172,327	172,327	34,304	82%
602	Mallë dhe Shërbime të Tjera	38,342	45,146	43,773	43,773	43,773	17,941	65%
603	Transferita Korrente						0	
606	Transferita Korrente të Hija	1,243	220	200	200	1,851	668	74%
607	Transferita Korrente të Hija						0	
606+607	Transferita Korrente të Hija	110,891	111,091	112,780	112,780	112,780	11,545	99%
602+606	Shpenzime nga tjetër	147,772	156,237	155,733	156,679	128,551	30,148	92%
	Shpenzime Korrente	241,897	319,851	329,019	329,019	329,019	30,148	92%
230	Kapitale të Përdorueshme			500	500	500	500	33%
231	Kapitale të Trajtuara	18,422	222	10,620	10,620	10,620	10,620	7%
239	Shpenzime Kapitalë	18,422	222	10,620	10,620	10,620	10,620	7%
	Totali i Shpenzimeve	260,319	320,073	339,639	339,639	339,639	30,556	74%

Bazimi: Drejtoria e financës

2.2. Çelja e fondeve buxhetore të vitit dhe ndryshimet sipas akteve normative. Kërkimi i realizimit të shpenzimeve bazuar në nivelin e fondit të çelur.

Kërkimi i planifikimit buxhetor me PBA për vitin 2023:

PBA 2023-2025 me planin buxhetor 2023, paraqitet në tabelën e më poshtme:

Në 000/lekë

Nr.	Emërtimi	Plan përfundim 2023	Sipas PBA 2023-2025	Ndryshimi
1	Shpenzime për pagat (600+601) (nga të ardhurat e grantit i pakushtueshëm)	191,788	172,527	19,461
2	Shpenzime (602,604-609) (nga të ardhurat e grantit i pakushtueshëm)	71,292	52,807	20,485
3	Investime Buxhetare (nga të ardhurat e grantit i pakushtueshëm)	11,382	10,620	1,762
4	Investime nga FZJSH			

Nga auditimi i procedurave për përgatitjen PBA 2023-2025, u konstatua se janë realizuar fazat e përgatitjes, është bërë ngritja e grupit të punës, është bërë analiza e kërkesave për nevojat për punë, mallë e shërbime, llogaritja e planifikimit për të ardhurat e veta, përcaktimi i tavanëve të shpenzimeve sipas programeve, etj.

Për hartimin e programeve buxhetore afatmesme dhe projektbuxhetet vjetore janë kryer konsultime me komunitetin dhe grupet e interesit në njësinë e vetëqeverisjes vendore. Buxhetet janë hartuar mbi bazën e kërkesave shkresore nga njësi administrative, drejtoritë e shkollave, sektorët e bashkisë etj. gjë që vërteton se prej tyre janë marrë kërkesat për nevojat reale e mbi bazën e tyre dhe të buxhetit faktit të mundshëm janë përzgjedhur ato më prioritare.

Me Urdhër nr. 35, datë 20.01.2022, është ngritur Grupi për Menaxhimin Strategjik (GMS) për përgatitjen e Programit Buxhetor Afatmesëm 2023- 2025.

Planifikimi i programit buxhetor afatmesëm 2023- 2025 është miratuar me Vendim të Këshillit Bashkiak me nr. 54 datë 30.12.2022, konfirmuar nga Institucioni i prefektit Qarkut Shkodër me shkresën nr. 94/I datë 26.01.2023.

PBA (taza rëbësore dhe përfundimtare) janë miratuar në Këshillin Bashkiak me vendimet:

a-PBA 2023-2025 miratuar respektivisht me VKB nr. 30, datë 04/07/2022 (projekti vendim nr.20, datë 28.6.2022) me VKB nr. 54, datë 30/12/2022 (Projekti Vendim nr.36, datë 25.11.2022)

Viti i parë i PBA është njëkohësisht edhe vit buxhetor vjetor.

Gjatë hartimit të PBA, 2023-2025 janë përcaktuar "Përshtikimi i çdo programi"; "Politikat e programit"; "Qëllimi Politikës së programit"; "Objektivat e politikës së programit".

PBA	Udhëzuesi GMS		Udhëzuesi LKP		Objekti	VKB		Nr. Program	Shënime
	Nr.	Date	Nr.	Date		Nr.	Date		
2023-2025	35	20.01.2022	35	20.01.2022	miratim kalendrar	54	30.12.2022	12	
					miratim buxhetor	12	30.01.2022	12	miratim
					miratim tregues	54	30.12.2022	12	miratim

Bazimi: Drejtoria e Financës

Për vitin 2023, buxheti bazë/fillestar vjetor (në bazë të vlerësimit të të ardhurave dhe të transferatave të palenshtëzuara të përcaktuara në ligjin e buxhetit vjetor), është miratuar me VKB nr. 54, datë 30.12.2022, konfirmuar nga Institucioni i prefektit Qarkut Shkodër me shkresën nr. 94/I, datë 26.01.2023.

Në këtë VKB, të ardhurat nga buxhetet e veta të planifikuara për vitin 2022 kanë vlerën 28,555,000 lekë, transferata e pakushtëzuara ka vlerën 93,105,000 lekë, transferata specifike ka vlerën 101,810,000 lekë, transferata e kushtëzuara në vlerën 103,905,000 lekë, të trashëguara në vlerën 12,284,000 lekë. Në total të ardhurat kanë vlerën 339,659,000 lekë.

Gjatë vitit 2023, janë marrë gjithashtu edhe disa vendime të tjera të këshillit bashkiak të cilat kanë bërë që të ndryshojnë vlerat e buxhetit bazë (miratuar në dhjetorë 2022). Këto ndryshime paraqiten si vijon:

- Me VKB nr. 11, datë 29.4.2023 është marrë vendim nga këshilli bashkiak Fushë Arrëz për miratimin e buxhetit shtesë për alkimin e fondeve të trashëguara nga viti 2022, duke planifikuar të ardhura dhe shpenzime shtesë në vlerën 36,028,000 lekë.

- Me VKB nr. 13, datë 11.8.2023 është marrë vendim nga këshilli bashkiak Fushë Arrëz për miratimin e buxhetit shtesë për alkimin e fondeve të trashëguara nga viti 2022, duke planifikuar të ardhura dhe shpenzime shtesë në vlerën 33,667,000 lekë.

- Me VKB nr. 27, datë 30.10.2023 është marrë vendim nga këshilli bashkiak Fushë Arrëz për miratimin e buxhetit shtesë për alkimin e fondeve shtesë të vitit 2023, duke planifikuar të ardhura dhe shpenzime shtesë në vlerën 750,000 lekë.

Nr.	Rimërtimi	Plan përfundim 2023	Sipas PBA 2023-2025	Ndryshimi
	Total i planit fillestar	278,461	235,754	42,708
	Shtesat nga Pushteti Qendror			
5	Investime grant e kushtëzuar			0
6	Shpenzime për pagat (600-601)	4,154	2,105	2,049
7	Shpenzime (602,604,609)	96,478	10,600	-85,878
	Grant e kushtëzuar (230-231)	11,100		11,100
	Gjithsej	410,104	339,659	70,445

Burimi: Nga pasqyrat e të dhënave sipas planeve të paraqitura nga subjekti.

Nga auditimi konstatohet se ndryshimet ardhis planit buxhetor vjetor 2023 dhe planit vjetor 2023 në PBA vijonë si rezultat i shtesës së rritjes së pagës sipas VKM nr. 328 datë 31.5.2023 "Për klasifikimin e funksioneve, grupimin e Njësive të vetëqeverisjes vendore, për efekt pagë, dhe caktimin e kufijëve të pagave të funksionarëve të zgjedhur e të emëruar, të nëpunësve civile e të punonjësve administrativë të njësive të vetëqeverisjes vendore", VKM nr. 326, datë 31.5.2023 "Për pagat e punonjësve mbështetë dhe punonjësve të tjerë të specialiteteve të ndryshme në disa institucione të administratës publike", VKM nr. 241, datë 20.04.2023 "Për çështje ndryshime në VKM nr. 175, datë 8.3.2017 "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve mësimore dhe të punonjësve të tjerë jomësimorë, në Arsimin parauniversitar, të ndryshuar", VKM nr. 240, datë 20.04.2023 "Për një ndryshim në VKM nr. 350 datë 19.04.2017 "Për trajtimin me pagë dhe shtesa mbi pagë të punonjësve të shërbimit të mbrojtjes nga zjarri dhe shpëtimit", të ndryshuar, VKM nr. 325, datë 31.05.2023 "Për rindatimin e strukturës së pagave, nivelit të pagave dhe shtesave të tjera mbi pagë të zëvendësministrat, funksionarëve të kabineteve, prefektit, nënprefektit, nëpunësve civile dhe nëpunësve të disa institucioneve të administratës publike".

Plani përfundimtar i buxhetit ka diferenca prej 70,445 mijë lekë nga plani në PBA për shkak se në planin përfundimtar janë pasqyruar rritja e grantit të kushtëzuar 11,100 mijë lekë, shpenzime për pagat (600-601) në vlerën 19,461 mijë lekë, shpenzime (602, 604, 609) në vlerën 20,485 mijë lekë dhe investime nga granti i pakushtëzuar në vlerën 2,762 mijë lekë për llogaritë e sipërcituar sipas tabelës.

Në programet buxhetore është bërë shpërndarja e fondeve të vënë në dispozicion nga Pushteti Qendror të granteve nëpërmjet transferes së pakushtëzuar, transferes së kushtëzuar dhe fondeve të krijuar nga burimet e veta, për kryerjen e funksioneve të veta, ato të deleguara dhe të përbashkëta si dhe shpërndarjen e fondeve të granteve.

Ndarja e plan buxhetit dhe detajimi i tyre në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nën artikulli është kryer në respektim të disiplinës buxhetore sipas strukturës dhe burimeve të financimit. Gjatë vitit si rezultat i çeljeve të reja në llogarinë e njësisë vendore në thesar, vlerat përkatëse të buxhetit vjetor kanë pësuar ndryshime në kuptimin e vlerës totale, pasi janë çelur fondet për funksionet e deleguara, granteve qeveritare, ndihma ekonomike, gjendje civile, shpërblime lindje, etj., të cilat nuk kanë qenë të pasqyruara në çeljen fillestar të vitit.

Gjatë viteve janë kryer ndryshime në buxhet (shtesa/ paksime). Këta lëvizje në rastet e lëvizjeve brenda të njëjtit artikull dhe brenda programit janë kryer me urdhër të Titullarit në mbështetje të Udhëzimit nr.9 dt.20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të Buxhetit" pikë 110 germa "h" dhe "e" ndërmjet zërave të shpenzimeve kapitale, brenda të njëjtit program, miratohen nga Kryetari i Njesisë së Qeverisjes Vendore, ndërsa lëvizjet nga programi në program dhe nga një artikull në tjetrin janë kryer me Vendim të KB.

- Planifikimi dhe detajimi i buxhetit në nivel artikulli dhe nënartikulli, është bërë sipas nevojave të paraqitura dhe kërkesave për fonde buxhetore, duke u bazuar në kërkesat e udhëzimeve përkatëse "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit".

- Akordimi fillestar i buxhetit dhe ndryshimet që kanë pësuar zërat e tij gjatë vitit, janë të rakorduar me Degën e Thesarit dhe janë të raportuara periodikisht pranë degës së Thesarit dhe në MFE. Situacionet e shpenzimeve janë të plotësuara sipas klasifikimit buxhetor për të gjithë periodhën e audituar. Fondet e akorduara në planet buxhetore dhe ndryshimet e bëra në periudha të ndryshme, janë evidentuar dhe janë ndjekur në dinamikë, në nivel titulli, kapitulli, artikulli dhe nënartikulli sipas shërbimeve dhe më vete për çdo njësi vartëse e sipas periudhave të planifikuara.

- Analiza e shpenzimeve buxhetore për artikuj dhe nënartikuj është bërë periodikisht mbi bazën e situacioneve mujore të konfirmuara nga Dege e Thesarit. Raportimi i realizimit të buxhetit është i shoqëruar me relacionin e realizimit të buxhetit duke argumentuar edhe shtesat e buxhetit gjatë periodhës ushtrimore për zërat e buxhetit të planifikuara dhe që nuk janë alokuar fonde që në fillim të periodes së buxhetit.

Janë kryer ndryshime të vazhdueshme në buxhetin vjetor, veprime që tregojnë se planifikimi i buxhetit duhet të bëhet më i argumentuar, në mënyrë që gjatë vitit ndryshimet të jenë sa më të vogla. Në mënyrë të detajuar ndryshimet buxhetore paraqiten në aneksin nr. 1 pika 1 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.

2.3. Analiza mbi suksesin e realizimit të treguesve buxhetor dhe pasqyrën në raportet e monitorimit *Fondet e shpenzuara nga njësi vendore, miratimi i këtyre fondeve sipas kaudrit rregullator në fuqi.*

Për zbatimet e buxheteve është rakorduar çdo muaj me Degën e Thesarit, si për shpenzimet e kryera ashtu edhe për të ardhurat, duke mbajtur akt-rakordimet përkatëse. Janë ruajtur kopjet e miratuar të shpenzimeve në total dhe për çdo artikull e nënartikull sipas klasifikimit ekonomik. Pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit viti 2023, referuar akt-rakordimet me thesarin paraqitet në si vijon:

Përshkrimi Shpenzimeve	Plani	Fakti	Realizimi në %
Paga 600	165,441,977	136,285,913	82
Sigurime shoqërore 601	27,558,323	22,409,672	81
Shp. Operat. 602 - F. Rezervë	51,164,248	33,233,177	65
Subvencion Ujëgjellësi, etj. 603			
K. Q. Emergj. Civile 604	2,529,057	1,864,463	74
Ind.ekonomi. investid 606	104,984,706	93,437,799	89
Mjete në majë 608			
Investime 230-231	78,694,228	52,550,259	67
Totali	430,372,533	339,776,281	79

Në mënyrë të detajuar pasqyra e realizimit të treguesve të buxhetit viti 2023, referuar akt-rakordimet me thesarin paraqitet në aneksin nr. 2 pika 1 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit

Planifikimi i buxhetit për zërin e shpenzimeve (të ardhurat e veta vendore, transfera e pa kushtëzuar, si dhe granti) ka vlerën **430,372 mijë lekë**, ndërsa realizimi **339,776 mijë lekë**, ose në masën 79%. Zëri shpenzime page është planifikuar në vlerën **165,441 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **136,285 mijë lekë**, ose në masën 82%, ndërsa zëri sigurime shoqërore është realizuar në masën 81%.

Zëri shpenzime operative është planifikuar në vlerën **51,164 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **33,233 mijë lekë**, ose në masën 65 %.

Zëri shpenzime kapitale (artikulli 230 dhe 231) është planifikuar në vlerën **78,694 mijë lekë** dhe është realizuar në vlerën **52,550 mijë lekë**, ose në masën 67 %.

Konkluzioni: Nga auditimi u konstatohet se realizimi i shpenzimeve buxhetore për vitin 2023 me të gjithë arat e vetë (pa transferien e paluajtshme) të Bashkisë Fushë Arrëz ka diferencë të dukshme me vlerën e planifikuar. Niveli i realizimit të investimeve të planifikuara, i cili është zëri më kryesor i buxhetit në lidhje me edukimin që ka në ofrimin e të ardhurave publike ndaj komunitetit, është akoma më i ulët se mesatarja e realizimit të buxhetit. Ku zëri shpenzime kapitale (artikulli 230 dhe 231) është planifikuar në vlerën 78,694 mijë lekë dhe është realizuar në vlerën 52,550 mijë lekë, ose në masën 67 %.

Ky mos realizim vjen si rezultat i mosarritimit të të ardhurave, ku nga 28,555 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 22,568 mijë lekë ose 79%, mos realizim në vlerën 5,987 mijë lekë dhe do të thotë se nga Bashkia Fushë Arrëz në fillim të vitit buxhetor ka planifikohen angazhime buxhetore duke mos u mbështetur në planifikime realiste të të ardhurave të veta nga taksat dhe tarrat vendore dhe ky planifikim nuk korrigjohet gjatë vitit, duke mos përshtatur shpenzimet buxhetore të miratuar me të ardhurat reale të realizuara. Veprimet dhe mosveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me pikën (a) të nenit 5, si dhe nenin 46 të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" dhe ngarkojnë me përgjegjësi Kryetarin e Bashkisë Fushë Arrëz z. Hilë Curri si dhe z. Dritan Lila, me detyrë Përgjegjësi i Sektorit të Financës.

Gjithashtu edhe gjatë vitit 2023 nuk është bërë analiza e zbatimit të buxhetit brenda muajit qershor dhe nuk është dalë në konkluzion nëse duhej rishikuar ose jo buxheti vjetor 2023.

Veprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Neni 46 "Rishikimi i zbatimit të buxhetit vendor, të ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", ku thuhet:

"Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore analizon zbatimin e buxhetit jo me vone se data 30 qershor e çdo viti dhe, në rast se është e nevojshme, harton e propozon në këshillin e njësisë së vetëqeverisjes vendore ndryshimet në buxhet. Procedurat e shqyrtimit, miratimit dhe zbatimit të ndryshimeve u nënshtrohen të njëjtave rregulla të përcaktuara në nenet 5 dhe 40 të këtij ligji."

2.4 Vlerësimi i risqeve buxhetore nga niveli i futurave të përkrahshme, vendimeve gjyqësore, vendimeve të shpirtërisht dhe niveli i realizimit të të ardhurave (fatmori e përlikshme të shprehur me listë analitike të detajuar me nr. fatmori, datë krijimit etj., sipas raportimit në MFE)
Në mënyrë të përmblodhur paraqitet fondet e trashguara për vitin 2022 dhe vitin 2023.

Fondet e trashguara në 31.12.2021 për përdorim në vitin 2022 sipas raportimit me thesarin (Llog. 520 në bilanc pa pjesën e llog 466)

81,576,242

Fondet e trashguara në 31.12.2022 për përdorim në vitin 2023 sipas raportimit me thesarin (Llog. 520 në bilanc pa pjesën e llog 466)

120,407,947

Detyrimet e prapambetura viti 2023

Kodi i detyrimit të prapamb.	Emërimi i detyrimit të prapambetur	Detyrimi i prapambetur progresiv deri në datën e miratimit të buxhetit vjetor 2023	Planifikim për likuidim në planin e buxhetit 2023 i vlerës së detyrimit të prapambetur	Pagues në fakt gjatë vitit 2023 e detyrimit të prapambetur të planifikuar në planin e buxhetit	Në lekë VKB nr. 54, datë 30.12.2024
4864100	Detyrime të p. per vend gjyqësor	5,515,568	5,515,568	5,515,568	
4864200	D.P.per shërbime	222,658	222,658	222,658	
4864300	D.P.per imentimajte				
4864400	D.P.per investime	576,124	576,124	576,124	
4864400	D.P.per investime nga Ministrit e Linjes				
	(specifiko FZ/HR etj)				
4865600	D.P per mirim				

4864900	D.P.e tjera				
	Totali	6,314,350	6,314,350	6,314,350	

Burimi: Bashkia Fushë Arrëz

Vlera e raportuar nga Bashkia Fushë Arrëz në MFE për detyrimet e prapambetura në datën 31.12.2023 është 0 lekë, konfirmuar me shkresën nr. 300 datë 29.01.2024 drejtuar Ministrit të Financave dhe Ekonomisë; Drejtorisë së përgjithshme të Buxhetit dhe Burimit Publik dhe Drejtorisë së Financave Vendore, e cila luadhen me detyrimet e paraqitura në pasqyrat financiare drejtuar degës së Thesarit Fushë Arrëz me shkresën 677 prot., datë 11.01.2024 të konfirmuara.

Bashkia Fushë Arrëz në datën 01.01.2023 ka pasur si çelje të vitit ushtrimar detyrime të prapambetura progresive vlerën 6,314 mijë lekë, e cila ka si burim financiar të ardhurat e veta. Në planin e buxhetit vjetor 2023 është planifikuar për likuidim gjatë kësaj viti vlera 6,314 mijë lekë, e cila është likuiduar 100% e vlerës së planifikuar.

Konstatohet se nga auditimi i zbatimit të buxhetit lidhur me likuidimin e detyrimeve të prapambetura rezultoi se Bashkia Fushë Arrëz për zbatimin e vendimeve gjyqësore me objekt dëmtshpërblim page për largime nga puna të punonjësve, për vitin 2022 ka shpenzuar vlerën 5,515,568 lekë, për rastet, sipas aneksit nr 3 pika 1 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit, që cilat përbëjnë shpenzime pa ekonomicitet, efizienz dhe efektivitet, pa praktikisht për një pozitën punë paguhen dy persona. Gjithashtu konstatohet se për likuidimet e subjekteve të nënsipërme janë nxjerrë urdhrat përkatës nga titullat i instancionit, por nuk janë analizuar nga Kryetari i Bashkisë dhe nuk është kërkuar prej tij nxjerrja e përgjegjësisve administrative për këto vendime. Analizimi i arsyeve të humbjeve të vendimeve gjyqësore dhe nxjerrja e përgjegjësisve administrative për ta, do të ndikonte pozitivisht në korrigjimin e praktikave të gabuara të ndjekura nga njësitë vendore në proceset e largimit të punonjësve nga puna dhe për çështje të tjera gjyqësore. Evidencat e procedurave të bera gabim, në kundërshtim me kadrin rregullator në fuqi, e si rezultat shmanjen e tyre në të ardhmen dhe uljen e shpenzimeve financiare negative në buxhet. Këtu veprime dhe masave janë në kundërshtim me pikën nr. 60. të CMFE nr. 9, datë 26.03.2018, "Për procedurat standarde të zbatimit të buxhetit", i ndryshuar.

(Si më sipër subjekti i audituar nuk ka paraqitur observacion mbi konstatimet e grupit të auditimit deri në këtë fazë)

1.6. "Niveli i realizimit të të ardhurave dhe mënyra e përdorimit të tyre. Vlerësimi i mbledhjes së të ardhurave në përputhje me dispozitat ligjore dhe borxhi tatimor, u shqyrtua dokumentacioni i mëposhtëm:

- Pasqyrat në lidhje me ardhërimet e të ardhurave nga subjektet, familjarët, taksat e tokës, etj.
- Dokumentacioni i sektorit të taksave dhe tarifave vendore në lidhje me mënyrën e mbajtjes së regjistrave të tatim-paguesve, shkarkime nga Programi Excel i mbajtjes së taksave. Evidencat e debitorëve për bizneset dhe familjarët, për taksat dhe tarifën vendore;
- Akt-rakordimet me degën e Thesarit dhe raportimet mbi realizimin faktik të të ardhurave, monitorimi dhe analiza mbi performancën e realizimit të të ardhurave të planifikuara;
- Dokumentacion tjetër i vënë në dispozicion nga Drejtoria e tatim-taksave.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar u konstatua:

➤ Strukturat për administrimin dhe mbledhjen e taksave dhe tarifave vendore

Për vitin 2023 numri i përgjithshëm i punonjësve është miratuar me VKB nr. 53, datë 30.12.2022, "Për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Fushë Arrëz dhe Institucioneve të Varësishë dhe funksioneve të transferuara për vitin 2023", ku përfshihet edhe struktura e taksave dhe tarifave vendore, e cila sipas strukturës është e përbërë nga sektorë dhe në total ka 5 punonjës nga të cilët 3 punonjës sipas njësive administrative dhe 2 punonjës të sektorit të taksave ku 1 përgjegjës Sektori i taksave dhe tarifave vendore, 1 specialist i, 1 specialist taksash në njësit administrative.

Struktura e Drejtorisë të Ardhurave Lokale për vitin 2023 është paraqitur si më poshtë:

No.	Paraqitja e funksioneve	Pozicioni	Drejtuesi	Ndalojmë nga 2023 (në sipas)
1	Shef i Sektorit	Shef i Sektorit i Ardhurave Lokale	15.05.2021	15.05.2021
2	Specialist i Taksave dhe Tarifave	Specialist i Taksave dhe Tarifave	10.01.2023	10.01.2023
3	Specialist i Taksave dhe Tarifave	Specialist i Taksave dhe Tarifave	10.01.2023	10.01.2023
4	Specialist i Taksave dhe Tarifave	Specialist i Taksave dhe Tarifave	10.01.2023	10.01.2023
5	Specialist i Taksave dhe Tarifave	Specialist i Taksave dhe Tarifave	10.01.2023	10.01.2023

Burimi: Bashkia Fushë Arrëz

Konstatohet se: Struktura e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Fushë Arrëz ka probleme dhe nuk është në funksion të realizimit të të ardhurave, edhe pse është krijuar Sektori i Masave Shitëse si një nga sektorët më të rëndësishëm në sektorin e Taksave dhe Tarifave Vendore Bashkia Fushë Arrëz, pasi evidentohet se një numër i lartë i detyrimeve të paqyrtuara (debitor), në vlerën **21,319,900 lekë**, kjo nisur nga fakti se kanë natyrë të ndryshme pune dhe se arkëtimi i debitorëve është procedurë më vete dhe afate të përcaktuara si dhe janë evidentuar lëvizje të shpeshta të stafit si dhe mangësi në plotësimin e strukturës organizative me specialist konkretisht; Specialist IT për përdorimin e programit kompjuterik eku sjell mos evidentimin e subjekteve, mos llogaritjen e detyrimit fiskal për këtu mos deklarime si dhe mos arkëtimin e të ardhurave. Kjo për mungesë stafi, në kundërshtim me pikën (c) të rrethit 5 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" i ndryshuar dhe në Kërkim XI- "Mbledhja me force të detyrimit tatimor të paguesit", nenet 58 – 104, të ligjit nr. 9920, datë 19.04.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH" me ndryshime, si dhe Rregulloren e Brendshme miratuar me shkresën nr. 737 prot datë 07.02.2018, Veprimet dhe mosveprimet ngarkojnë me përgjegjësi nëpunësin Autorizues si dhe Drejtorin e Burimeve Njerëzore dhe Shërbimeve Mbrojtëse.

-Nga sektori i taksave dhe tarifave vendore, nuk është bërë miratimin i informacionit tatimor, të subjekteve tatimpagues të biznesit të vogël edhe të biznesit të madh, për të gjitha detyrimet tatimore dhe nuk janë vendosur në dosjet e çdo taksa paguesi, nuk është bërë përditësimi i të dhënave dhe nuk është plotësuar dokumentacioni, ku të regjistroheshin të gjitha detyrimet e tatimpaguesit, sipas kategorisë së detyrimit, interesat, gjatësi dhe pagesat, që i takojnë tatimpaguesit. Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me kërkesat dhe përcaktimet e ligjit nr. 9920, datë 19.04.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", Neni 29 Dosja e detyrimeve tatimore, pika 1, cihet : "Administrata tatimore krijon dhe përditëson dosjet e detyrimeve tatimore, ku regjistrohen të gjitha detyrimet e tatimpaguesit, sipas kategorisë së detyrimit, interesat, gjatësi dhe pagesat, që i takojnë tatimpaguesit"

-Nga Sektori i taksave dhe tarifave vendore, nuk është vepruar për të kryer inventarizimin e dokumentacionit që mbledheshin në dosjet e subjekteve tatimpagues të taksave dhe tarifave vendore ku nga auditimi u konstatuan me mangësi e konkretisht:

-të gjitha praktikat nuk shqyrtohen me fletë inventari për numrin dhe llojin e dokumenteve dhe shkresave që përmban një dosje e subjektit.

-i gjithë dokumentacioni i subjektit mbahet në një dosje qysh nga krijimi i subjektit për disa vite me radhë.

-praktikat e përfunduara të viteve të mëparshëm nuk janë dorëzuar në arkivin e institucionit

Veprimet dhe mosveprimet janë në kundërshtim me kërkesat e ligjit nr. 9154, datë 6.11.2003 "Për arkivat" nenat 24, ku përcaktohet: Arkivat e institucioneve shtetërore qendrore dhe vendore kanë detyrë : a) të erudencojnë korrespondencën që dërgohet ose merret nga institucionet b) të bëjnë përpunimin arkivor të ruajnë dhe të shërbejnë dokumentet që administrojnë, c) të dorëzojë dokumentet në arkivat shtetërore, sipas afateve legjore përkatësisht sipas përshkrimit në nenin 9 shkronjat "b", "c", "q" dhe "d" të këtij ligji, dhe me rregulloren e Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave "Për normat tekniko-profesionale dhe metodologjike të shërbimit arkivor në Republikën e Shqipërisë" kapitulli II Rregulla për punën me dokumentet administrative në subjektet shtetërore dhe jo shtetërore neni 21 dhe neni 27

➤ Parashikimi dhe realizimi i taksave dhe tarifave vendore sipas llajeve

Për vitin 2023, Paketa Fiskale e taksave dhe tarifave vendore është miratuar me VKB nr. 52, datë 30.12.2022, e konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Shkodër meshtresën nr. 53/1 prot., datë 19.01.2023. Nga të dhënat e pasqyrës aneks nr. 1 pika 1.6 hashtkëlidhur projekt raportit të auditimit, shihet se për vitin 2023 sipas planit janë në vlerën 28.555 mijë lekë të planifikuara, janë realizuar 22,568 mijë lekë ose 79%, mas realizim në vlerën 5,987 mijë lekë, kryesisht në taksat e popullatës, si p.sh. taksa e ndërtësës, tarifa e pastrim-gjellbërimit, tarifë për shfrytëzimin e lëndëve ardhurasetj. Konstatohet se:

-Tatimi i thjeshtuar cabi titullin, nuk është planifikuar nuk ka një databazë të saktë për numrin e subjekteve të cilët gjatë vitit mbylleten dhe regjistrohen, nuk ka bazë të dhënash për subjektet të cilët në bazë të xhires do paguajnë tatimin e fitimit. Taksa e mjeteve të përdorura është planifikuar sipas të dhënave historike pra nuk ka një databazë të saktë për numrin e mjeteve të përdorura që ka Bashkia Fushë Arrëz. Taksa e kalimit e të drejtës në pronësi nuk është planifikuar si burim i krijimit tatimor. Sektori i taksave dhe tarifave vendore, duke mospatur një bazë të dhënash nuk ka bërë rakordime me Drejtorinë Rajonale Tatimore Shkodër (DRTB), Agjencinë Shtetërore të Kadastres (ASJKK) dhe Drejtorinë e Shërbimit të Transportit (DSHTRR).

Nga auditimi, e konstatua se në lidhje me detyrimet e abonentëve familjarë, Bashkia Fushë Arrëz nuk ka krijuar një bazë të dhënash të plotë dhe të saktë për familjet, ku të përcaktohet numri i familjeve dhe sasia e sipërfaqes së hartimit që ka secila familje, kajt viteve i përket banesa, para apo pas vitit 1993, sa kanë paguar, sa nuk paguajnë dhe sa familje janë të përjashtuar nga pagesa e këtyre taksave, nuk është plotësuar rregullisht njësimi i detyrimit për çdo familje, si për taksin e ndërtësës edhe për tarifën e pastrim-gjellbërimit-ndërtimit. Për detyrimet e familjarëve, u konstatua se shoqëria Ujësjetës-Kanalizime rajonal është caktuar si Agjenti Tatimor për vjeljen e taksës së ndërtësës e të truallit dhe tarifën e pastrimit dhe të shërbimit sipas paketës fiskale por nuk ka funksionuar.

Akt rakordimet me agjentët tatimorë nuk janë mbajtur sipas formatit të përcaktuar me Udhëzim të pasqur nga Ministria e Financave. Rakordimet janë bërë në formë proces-verbalesh, duke marrë informacion vetëm për sasinë e arkëtimeve, por nuk mund të konsiderohen rakordime pasi nuk ka asnjë të dhënë statistikore në bazë të së cilës të bëhen llagaritjet dhe të vlerësohet niveli i mbledhjes së të ardhurave, veprime në papajtueshmëri me ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Neni 117 "Dënimet për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim, agjentët e taksave dhe agjentët e tarifave", ku përcaktohet se: "Agjenti i mbajtjes së tatimit në burim, agjenti i taksave apo tarifave, që nuk arrin të mbledhë, të llogaritë, të raportojë dhe të transferojë në Buxhetin e Shtetit tatimin në burim apo tatimet, taksat dhe tarifat e mbledhura, apo i shkarkojt mbledhjes së tyre detyrohet të pagtojë gjatë të barabartë me 30 për qind të shumës së plotë të tatimit, taksës apo tarifës së mbledhura apo të shkarkuara".

➤ Agjentët tatimorë dhe rakordimet mujore me ta:

Konstatuar se në rregulloren e brendshme të institucionit të miratuar me shkresën nr. 06.12.2019, nuk është përcaktuar personi i cili duhet të ketë për detyrë ndjekjen e arkëtimeve nga agjentët

tatimorë dhe mbajtjen e aktakordimeve agjentët tatimorë si dhe krijimin e një databaze me të dhëna respektivisht nga agjentët:

1. Për Taksa vjetore e mjeteve të përdorura, mbledhet nga Agjenti Tatimor "Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Transportit Rrugor (DSHTRR)", për llogaritë të Bashkisë Fushë Arrëz. Në zbatim të ligjit nr. 10458, datë 21.07.2011 për disa ndryshime në ligjin nr. 9975 datë 28.07.2008 "Për taksat kombëtare", të ndryshuar dhe në mbështetje të gërmës "b", të pikës 2, në nenin 35 "Të ardhurat nga taksat e ndara" të ligjit nr. 6872017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", pushtetit vendor për mjetet e regjistruara në juridiksionin e njësive përkatëse i kulojnë 25 për qind e të ardhurave nga taksat vjetore e mjeteve të përdorura. Rakordimet me DSHTRR-në për taksën vjetore të mjeteve të përdorura, nuk janë kryer.

2. Tatimi i thyeshituar mbi fitimin për biznesin e vogël, mbledhet nga Agjenti Tatimor "Drejtoria Rajonale e Tatimeve (DRT) Shkodër".

Në zbatim të ligjit nr. 181 datë 28.12.2016 "Për disa ndryshime në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" dhe në zbatim të Udhëzimit të Ministrisë së Financave nr. 32 datë 31.12.2013 "Për tatimin e thyeshituar të biznesit të vogël" Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, nëpërmjet Drejtoreve Rajonale Tatimore, është e ngarkuar me vlerësimin, mbledhjen, kontrollin, arkëtimin dhe transferimin në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore të të ardhurave nga tatimi i thyeshituar mbi fitimin e biznesit të vogël. Në llogaritë e buxhetit të qeverisjes vendore ku biznesi i tatueshëm është i vendosur, Administrata Tatimore Qendrore, brenda datës 10 të muajit pasardhës, bën transferimin e të ardhurave nga ky tatim. Rakordimet me Drejturinë Rajonale Tatimore Shkodër për efekt të tatimit mbi fitimin e biznesit të vogël, nuk janë kryer megjithatë çdo muaj.

3. Taksa mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme, mbledhet nga Agjenti Tatimor "Zyra Vendore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZVRPP)".

Në zbatim të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006 "Për sistemin e taksave vendore" të ndryshuar, Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme janë përcaktuar si Agjent Tatimor për vjeljen e taksës mbi kalimin e të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme. Për kryerjen e këtij procesi, ato përfitojnë si komision 5% të shumës totale të arkëtuar dhe pjesën e mbetur e kalojnë ju me vonë se data 30 e muajit pasardhës për llogaritë të buxhetit përkatës të bashkisë, në territorin e së cilës ndodhet pasuria. Rakordimet me ZVRPP Shkodër, për taksën e kalimit të të drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme, nuk janë kryer.

4. Renta Minerare nga Agjentët Tatimorë "Drejtoria Rajonale Tatimore (DRT) dhe Drejtoria Rajonale Doganore (DRD) Shkodër".

Në zbatim të të Ligjit nr. 9975, datë 28.07.2008 "Për Taksat Kombëtare", të ndryshuar, Neni 4 "Niveli i Taksave Kombëtare", pika 4, e cila shprehët: "Renta minerare llogaritet si detyrim i subjektit taksapagues, në rastin kur ai shet produkte minerare... As për qind e të ardhurave nga renta minerare i kalojnë pushtetit vendor ku zhvillohet veprimtaria. Renta minerare përvetësohet duke shumëzuar vlerën e përgjithshme të shitjes me shumicë të produktit me përqindjen e rentes..." të Udhëzimit nr. 26, datë 04.09.2008, dhe UMF Nr. 12, Dt. 4.4.2017, "Për Taksat Kombëtare", "...Daget e doganave në rrethë ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e eksportit të produkteve minerare, ndërsa daget e tatimeve ngarkohen për arkëtimin e kësaj rente, në rastin e shitjes së produkteve minerare brenda vendit...", sipas shtojcën 2 të këtij ligji, niveli i Rentës Minerare varion nga 4 deri në 10%, sipas llojit të mineralit. Rakordimet me Drejtoria Rajonale Tatimore (DRT) dhe Drejtoria Rajonale Doganore (DRD) Shkodër, për Rentën Minerare, nuk janë kryer.

➤ Taksa e tokës:

Nga auditimi i dokumentacionit mbi planifikimin e taksës së tokës bujqësore për vitin 2023, u konstatua se kishte rezerva në planifikimin, pasi sipas të dhënave të marra nga sektori i bujqësisë,

dhe trajtimin të AMTP, mbi ndarjen e tokës bujqësore për familje dhe bonitetin, evidentohet mas planifikimit në vlerën **487,600 lekë**, konkretisht:

Aneksi nr. 6. Përshkrimi i taksës së tokës bujqësore për vitin 2023

NLA	Gjendja në fund të mbajtjes	Sip (m2)	Kategoria	Cvërimi sipas pasqyrës	Planifikimi sipas	Llogaritimi	Mosrealizimi
NLA Qendër	370	130 ha	Kategoria 1 VII	700	105,000	11,500	93,500
NLA Qafë-Mali	1115	455 ha	Kategoria 2 VII	500	230,000	15,000	215,000
NLA Hialle	1500	612 ha	Kategoria 3 VII	700	427,000	2,000	425,000
NLA Blerim	800	321 ha	Kategoria 4 VII	900	285,000	4,000	281,000
NLA Ierzë	761	561 ha	Kategoria 5 VII	500	280,000	4,000	276,000
Shuma		2422			1,091,000	41,500	1,049,500

Burimi: Bashkia Fushë Arrëz dhe auditimet e ue parashme të KLSH-së

Sa më sipër konstatohet se referuar të dhënave nga Bashkia Fushë Arrëz nuk disponon të dhëna analitike mbi sipërfaqen e AMTP të ndara sipas ligjit 750 "Për tokën" çka do të thotë se planifikimi i taksës së tokës nuk është real. Kështu sipas të dhënave të pasqyrës sipërfaqja gjithsej e tokës së ndarë sipas fshatrave dhe familjeve për njësit administrative në Bashkinë Fushë Arrëz është 2322 ha e ndarë sipas kategorive. Për këtë sasi toke të ndarë, referuar boniteti të tokës sipas fshatrave dhe emetit për bonitetin të miratuar në paketat fiskale me VKB Planifikim i kësaj taksë për vit ushtrimor duhet të ishte në vlerën **1,107,600 lekë** dhe jo në vlerën **620,000 lekë** sipas aneksit nr. 2 të sipërcituar, në fakt nga sektori i taksave dhe tarifave vendore Bashkia Fushë Arrëz është realizuar në vlerën **29,680 lekë**, mosrealizim në vlerën **590,320 lekë** sipas planifikimit nga vetë bashkia dhe mosrealizim në vlerën **1,077,920 lekë** sipas llogaritjeve të grupit të auditimit.

➤ **Rregullimet, regjistrimi dhe mbajtja e të dhënave:**

Administrimi i taksave vendore nuk bëhet me program, nuk janë të pasqyruara regjistrat, sipas aktiviteteve, njallim detyrimet dhe pagesat, kjo si për subjektet fizike/juridik dhe abonentët familjarë. Nga të dhënat që kërkohen për auditim, konstatohet se informacionet që kërkohen të dhënat nuk dalin të analizuarra për çdo zë tatimor që sektori i taksave dhe tarifave vendore bashkia fushë arrëz aplikon.

Referuar të dhënave të marra nga sektori i taksave dhe tarifave vendore Bashkia Fushë Arrëz, situata e lëvizjes së subjekteve paraqitet si më poshtë:

Nr	Lloji i biznesit	Viti	Gjendja në fillim	Regjistrime të reja	Mbyllur Aktiviteti	Gjendja në fund të periudhës
	Biznesi i vogël	2023	85	7	-	85
	Biznesi i madh	2023	46	-	-	46
	ETOTAL		138	7	-	131

Burimi: Bashkia Fushë Arrëz

➤ **Menaxhimi i borxhit nga taksat e tarifave vendore.**

Nga auditimi i të dhënave, rezulton se më datën 31.12.2023 për mos pagesën e detyrimeve tatimore janë debitorë subjektet e biznesit të vogël, biznesit të madh në vlerën **21,319,900 lekë**, vlerë e cila konsiderohet debitor të pa arkëtuar për buxhetin e Bashkisë Fushë Arrëz dhe vlera **1,859,987** është krijuar brenda vitit 2023

Referuar të dhënave të vënë në dispozicion grupit të auditimit të KLSH, konstatohet se, gjendja e debitorëve paraqitet si vijim:

	Nr	Vlerë	Nr	Vlerë	Nr	Vlerë
Hizmat i Maltë	8	7,425,531	29	1,190,502	20	8,525,626
BIZNESI VETËM	23	9,761,229	39	940,145	39	10,201,374
INSTITUCIONET	7	2,269,550	6	320,250	6	2,589,800
Shuma	38	19,456,310	74	1,850,897	74	21,519,909

Burimi: Bashkia Fushë Arëz

Rezulton se sektori i taksave, dhe tarifave vendore në Bashkia Fushë Arëz nuk ka llogaritur penalitetin (kamatëvonesë), për mos likuidim në afat të detyrimeve si dhe nuk ka ndërmarr asnjë procedurë për bllokimin e llogaritve bankare. *Vepimet dhe masveprimet e mësipërme janë në kundërshtim me Krenën XI-Mbledhja me forcë e detyrimit tatimor të pajisur, të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", me ndryshimet dhe Udhëzimit nr. 24, datë 02.09.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", me ndryshime; ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, "Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, neni nenet 15 dhe 18; -Mospagimi i taksave dhe tatimeve, apo të parashikimit të vendimeve (vlerave) të gjobave të përcaktuara në nenin 46 të ligjit "Për Kundërvajtjet Administrative" (brenda 3 viteve), ligjin nr. 7895, datë 27.01.1995, me ndryshimet e mëvonshme, neni 181 -Mospagimi i taksave dhe tatimeve, me pikat 3,4, 5 dhe 5, të nenin 45 – "Çregjistrimi i subjekteve tatimore", të ligjit nr. 9920, datë 19.05.2008 "Për Procedurat Tatimore në RSH", me ndryshime.*

Për veprimet dhe masveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:

- z. Vikon Prenga, me detyr ish/përgjegjës i Sektorit Tatim-Taks, për periudhën 25.05.2021 e në vijim.
- Znj. Mario Curti me detyr Specialist i Tatim-Taksav, për periudhën 10.01.2022 e në vijim.

Përgjegjësi për vjeljen në kohë dhe administrimin e të ardhurave ka edhe kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore, sipas kërkesave të ligjit nr. 68/2017, datë 27.4.2017 "Për financa e vetëqeverisjes vendore", neni 42 "Administrimi i mjeteve monetare", pika 2, ku përcaktohet se: "Kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore merr masat dhe është përgjegjës për mbledhjen në kohë të të ardhurave vendore."

➤ **Pajisja me autorizime e subjekteve që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatat e tyre:**

Nga auditimi u konstatua se subjektet që tregtojnë hidrokarbure dhe derivatat e tyre, kanë marrësi në plotësimin e të dhënave, si në krijimin e një regjistri të pasqyem për këto lloj subjektesh, në evidentimin e subjekteve që u ushtrojnë këtë lloj aktiviteti dhe në mbledhjen e detyrimeve specifike për këto kategori biznesi. Nga auditimi i kësaj kategorie biznesi, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se nga Bashkia Fushë Arëz dhe Njësië Administrative **nuk është aplikuar tarifa për pajisjen me leje tregtimi për karburantet**. Nga auditimi i dosjeve të subjekteve që tregtojnë karburante në Bashkinë Fushë Arëz për vitet 2018 -2023 paraqiten 4 subjekte si më poshtë:

NR	Emërtimi i Subjektit	ADRESA	NIPT	Data e fillimit të aktivitetit	Aktiviteti i Tërmës
1	KULLI DIL SHIPK	FUSHE ARËZ	159016500	01/02/2014	Është pajisur me leje
2	LONATA SHIPK	FUSHE ARËZ	119715910	10/05/2011	Nuk është pajisur me leje
3	DIEZELA SHIPK	FUSHE ARËZ	K91420010	17/02/2009	Nuk është pajisur me leje
4	VEJJEZIT TITIL OIL SHIPK	FUSHE ARËZ	1589710010	12/11/2015	Nuk është pajisur me leje

Në mënyrë të përmblodhur paraqiten në pasqyrën në vijim, për subjektet që tregtojnë karburanteve, detyrimet, arkëtimet dhe vlerat e tarifës së pa likuiduar, të cilat nuk janë pajisur me

autorizime/licenca për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe për dhënie dhe përsëritjen e licencës për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë sipas pasqyrës si më poshtë:

* Pasqyra përmbledhojëse e subjekteve që nuk ka likuiduar madhësi e licencimit/autorizimit*

NR	Emërtimi i Subjektit	Data e fillimit të Aktivitetit	Afësi i përdorimit të licencës		Perioda e shfrytëzimit të Aktivitetit	Pagesa sipas VKM nr.344, dt 19.01.2017 Shtet Shkije	Diferenca për pagese
			07.01.2017	06.01.2022			
1	KULTOHI SHPK	01.02.2017	05.01.2022	05.01.2022	11 vjet	1,000,000	1,000,000
2			19.01.2017	18.04.2022			1,000,000
			18.04.2022	17.04.2027	13 vjet	1,000,000	1,000,000
3	DIEZELA SHPK	17.02.2019	19.04.2022	18.04.2022	5 vjet	1,000,000	1,000,000
			06.01.2022	17.04.2027	5 vjet	1,000,000	1,000,000
			19.04.2022	18.04.2022	5 vjet	1,000,000	1,000,000
4	VET E DZRII TUCI COL SHPK	01.02.2017	06.01.2022	17.04.2027			1,000,000
			06.01.2022	17.04.2027			1,000,000

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion konstatohet se nga Bashkia Fushë Arrëz në fund të vitit ushtrimitor 2023 ushtrojnë aktivitetin 4 subjekte të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënprodukte të tyre. Nga auditimi i kësaj kategorie të biznesëve, në lidhje me pajisjen me lejet përkatëse të tregtimit dhe pagesat e tyre, u konstatua se, subjekti Vilezrit Tuci ka lidhur marrëveshje me bashkinë duke filluar likuidimin e detyrimeve të propozuara dhe pajisjen me autorizim me autorizim 1 vjeçar ndërsa 3 subjekte nuk janë pajisur me autorizim 5 vjeçar sipas përcaktimeve të VKM nr. 344, datë 19.04.2017, në kundërshtim me VKM nr. 970, datë 2.12.2015 "Për përcaktimin e procedurave dhe të kushteve për dhënie e licencave për tregtimin e naftës bruto dhe nënprodukteve të saj" i ndryshuar kapitulli II, pikës 1 germës "b" ku cilësohet:

II. Procedura për dhënie e licencave për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, vajrave lubrifikante dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë

1. Dhënia e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve për tregtimin me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, e vajrave lubrifikante dhe të njësisve të lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët fundorë, bëhet nga:

a) Organi i qeverisjes vendore, sipas juridiksionit përkatës, në rastet kur stacionet e shitjes së karburanteve, që ushrojnë veprimtarinë e tregtimit të karburanteve për automjetet, gazit të lëngshëm e vajrave lubrifikante dhe të njësisve të shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë du të ndërtohen në territoret e tjera.

9. Pagesa për dhënie dhe për shtetjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm të naftës, për automjetet, dhe vajrave lubrifikante është 5 000 000 (pesë milionë) lekë, për Bashkinë e Tiranës dhe 2,000,000 (dy milionë) lekë, për bashkitë e tjera.

- Fila 9 ndryshohet, si më poshtë vijon me VKM nr.344, dt. 19.4.2017.

"9. Pagesa për dhënie dhe përsëritjen e licencave për stacionet e shitjes së karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet dhe vajrat lubrifikante, është 3 000 000 (tre milionë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 1 000 000 (një milion) lekë për bashkitë e tjera."

10. Pagesa për dhënie dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, është 1 000 000 (një milion) lekë, për Bashkinë e Tiranës dhe 200 000 (dyqind mijë) lekë, për bashkitë e tjera.

- Fila 10 ndryshohet, si më poshtë vijon: me VKM nr.344, dt. 19.4.2017.

"10. Pagesa për dhënie dhe përsëritjen e licencave për njësitë e shitjes së lëndëve djegëse, që ushtrojnë veprimtarinë e tregtimit të tyre për përdorim nga konsumatorët fundorë, është 500 000 (pesëqind mijë) lekë për Bashkinë e Tiranës dhe 100,000 (njëqind mijë) lekë për bashkitë e tjera."

"15.1 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, mjetin që ka për detyrë të japë licencën informon menjëherë, inspektoratit shtetëror përqiegjësi dhe bashkëpunon me të për marrjen e masave të nevojshme të sigurimit të subjekteve që ushtrojnë, pa licencë, aktivitetin e tregtimit me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të naftës për automjetet, vajrave lubrifikantë dhe lëndëve djegëse për përdorim nga konsumatorët finalë."

1A.2 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tregëtisë për subjektet e licencës dhe verifikohet në pikave të depozitimit apo të tregëtimit, në mënyrë që keto të fundit të kontrollojnë zbatueshmërinë e legjislacionit në fuqi.²

-VKM nr. 344, datë 19.04.2017, për disa ndryshime në VKM nr. 970, pika 15.1 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë licencën informon, menjëherë, inspektoratin shtetëror përjegjësi dhe bashkëpunon me të për marrjen e masave të bllokimit të veprimtarisë së subjekteve që ushtrojnë, pa licencë, aktivitetin e tregtisë me pakicë të karburanteve, gazit të lëngshëm, të nafës për automjetet, vajrave lubrifikantë dhe lëndëve djegëse, për përdorim nga konsumatorët finalë

15.2 Në përputhje me legjislacionin në fuqi, organi që ka për detyrë të japë lirësinë të formave Drejtorinë e Përgjithshme të Doganave dhe Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve për subjektet e licencuara dhe vendndodhjen e përfundimtare të depozituarit apo të tregtisë, në mënyrë që kjo të jetë në kontrollin zbatues të legjislacionit në fuqi."

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:

• **Z. Kristjan Vuerri**, me detyr ish/Drejtor i Drejtorisë së Shërbimeve Publike

➤ Pajisja me NUIS sekondare e Operatorëve Ekonomikë të cilët kryejnë veprimtari biznesi në Bashkinë Fushë Arrëz:

Bazuar në dokumentet e paraqitura nga Sektori i Planifikimit të Territorit dhe Investimeve rezultojnë se për përjudhjen objekteve auditimi janë lidhur 6 kontrata me OE të cilët janë shpërndarë fitues në procedurat e prokurimit si dhe kanë ushtruar aktivitet në territorin e Bashkisë Fushë Arrëz për një pajisje me NUIS/sekondar, në mënyrë të detajuar paraqitet në tabelën vijuese:

[illegible]

Thirrime: Sektori i Planifikimit të Territorit dhe Investimeve

Gjithashtu nga auditimi i paketës fiskale për vitin 2023 miratuar me vendimin nr. 52 datë 30.12.2022 konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Shkodër me shkresën nr. 53/1 datë 19.01.2023 rezultoi se Bashkia Fushë Arrëz nuk ka parashikuar aplikimin e taksave dhe tarifave vendore për subjektet e ndërtimit. (jo me seli kryesore/vendi efektiv i aktivitetit në Bashkinë Fushë Arrëz) të cilat kanë kryer punime ndërtimi dhe janë shpallur fitues në procedurat e prokurimitit me fonde publike në kundërshtim me Ligji 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore". I ndryshuar:

Neni 9 Të drejtat dhe përgjegjësitë

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kanë këto të drejta dhe përgjegjësi:

1.3. Të drejtën dhe përgjegjësinë e mbledhjes së të ardhurave dhe hërjes së shpenzimeve, sipas së cilës:

b) vendosin taksa vendore e tarifa për shërbimet, si dhe nivelin e tyre, në përputhje me legjislacionin në fuqi;

Neni 35 Të ardhurat që rrjedhin nga burimet e veta vendore

5. Dashedite krijojnë të ardhura nga tarifat vendore për:

a) shërbimet publike që ato ofrojnë;

Neni 54 Detyrat dhe kompetencat e këshillit bashkiak

Këshilli bashkiak ka këto detyra dhe kompetenca:

f) vendos për taksat e tarifat vendore, sipas këtij ligji dhe legjislacionit tjetër në fuqi;

-Ligji nr. 68/2017 "Për financat e Vetëqeverisjes Vendore"

Neni 3 Përkufizime

10. "Tarifë vendore" është një pagesë që një individ, person fizik apo juridik bën në shkëmbim të një shërbimi specifik të marrë, të mirë publike specifike të përdorur apo të drejta të dhënë nga njësi e vetëqeverisjes vendore.

Neni 12 Rregulla të përhashëkta për taksat vendore

2. Baza e taksave dhe tarifave, si dhe niveli i tyre, qdo përjashtim apo ulje, afati i pagesave, si dhe gjatësi e karnatëvotësas e aplikueshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi, botohen dhe bëhen të njohura publikisht.

Neni 14 Tarifa vendore

5. Njësitë e vetëqeverisjes vendore krijojnë të ardhura nga këto tarifa vendore:

b) tarifa për mbledhjen dhe largimin e mbetjeve;

Neni 18 Të ardhurat nga tarifat e shërbimeve të tjera publike

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore propozojnë ose miratojnë, sipas legjislacionit në fuqi, tarifa për mbledhjen dhe heqjen e mbetjeve, si dhe për furnizimin me ujë dhe kanalizimet.

2. Niveli i tarifave të shërbimeve publike, si rregull, synon mbulimin e kostes dhe është në përputhje me të drejtë me konsumin nga individët, personat fizikë ose juridikë.

-Ligji nr.9723, datë 3.5.2007 "Për regjistrimin e biznesit regjistrimet e tjera", i ndryshuar

Neni 2 Përkufizime

6. "Regjistrim" është regjistrimi fillestar dhe qdo regjistrim tjetër, përfshirë dhe reregjistrimin e subjektit nga regjistri.

Neni 43 Regjistrimet e tjera të detyrueshme

3. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, subjekti duhet të regjistrojë dhe të depozitojë aktet përkatëse, si më poshtë:

d) vendet e tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia;

-Ligji nr.9920, datë 19.5.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar

Neni 40 Regjistrimi i personave, që ushtrojnë veprimtari tregtare dhe jotregtare

5. Mosregjistrimi nuk e çliron një person nga pagesa e detyrimit tatimor ose përmbushja e detyrimeve të tjera tatimore.

-Udhëzimi nr.29, datë 2.9.2008 "Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, KREU III dispozita të përgjithshme administrative

23. Komunikimi me personat e tatueshëm

23.3.1 Komunikimi i vlerësimeve, njoftimeve, vendimeve dhe qdo akti tjetër zyrtar, nga ana e administratës tatimore, bëhet me postë elektronike ose me rrugë elektronike, nëpërmjet dërgimit të tyre në llogarinë e tatimpaguesit të hapur në sistemin elektronik të shërbimit tatimor, ose nëpërmjet

dërgimit në adresën e postës elektronike (e-mail) të tatimpaguesit, kur një adresë e tillë i është njoftuar nga vetë tatimpaguesi administratës tatimore, sipas udhëzimit për përqimin e formës elektronike.

40. Regjistrimi i personave që ushtrojnë veprimtari tregtare dhe jotregtare

Për çdo vend tjetër të ushtrimit të aktivitetit të ndryshëm nga adresa kryesore, personi fizik duhet të pajiset me një certifikatë me numër unik të identifikimit të tatimpaguesit të njëjtë me atë të regjistrimit, por me numër serial të ndryshëm, me qëllim identifikimin e vendndodhjes së re.

40.4 Personi i tatueshëm që ushtron veprimtari në adresa (vendndodhje) të ndryshme biznesi, pajiset me certifikatë regjistrimi për çdo adresë, e cila ka të njëjtin NIPF unik.

43. Ndryshimet në regjistrim 43.1

Sipas nenit 43 të ligjit, personat e tatueshëm që ushtrime veprimtari ekonomike e tregtare, janë të detyruar të deklarojnë në Qendrën Kombëtare të Biznesit, çdo ndryshim të mëvonshëm që lidhet me emrin, adresën e selisë dhe të degëve, formën juridike, krijimin e mbylljen e degëve, ndryshimin e llojit të veprimtarisë, etj., siç përcaktohet në dispozitat ligjore për QKR. Në përputhje me ligjin për regjistrimin e biznesit, aplikimi për ndryshimin e selisë dhe hapja e vendeve të tjera të ushtrimit të veprimtarisë, të ndryshme nga selia, në çdo rast bëhen përpara nisjes efektive të veprimtarisë në atë vend.

Për veprimet dhe mosveprimet e mësipërme mbajnë përgjegjësi:

- z. Vilson Prenga, me detyr përgjegjëse e Sektorit Tatim/Taks per periudhën 25.05.2021 e në vijim
- znj. Aurela Fota me detyrë ish/ përgjegjëse e sektorit juridik dhe prokurimeve.

(Sa më sipër subjekti i audituar nuk ka përvojat observacion mbi konstatimet e Grupit të auditimit deri në këtë fazë)

2 Mbi vlerësimin e raportimit financiar, plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike

2.1. Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike; Nënpika 2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe flukse të parasë; Nënpika 3. Opinioni mbi pasqyrat financiare;

U shqyrta dokumentacioni si më poshtë:

1. Pasqyrat financiare të vitit 2023 të shoqëruar me formatet 1-8.

2. Dokumenta kontabël si: ditarët e bankës, magazinës, pagave, të veprimeve të ndryshme, debitoreve, kreditorëve, furnitorëve, etj, centralizatori, bilanci vertorues.

3. Dokumentacioni i kryerjes së inventareve të aktiveve 2023, libri i aktiveve.

4. Urdhër-shpenzimet dhe dokumentacioni bashkëlidhur për vitin 2023

6. Akt-rakordimet me Degën e Tësarit në mbyllje të vitit buxhetor 2023.

8. Të tjera dokumente mbështetëse (databaze të ndryshme në programet "excel" si: për vendimet gjyqësore, për investimet, për dhurat, shpenzimet të ardhurat etj.).

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet që:

• **Raza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:**

Për vitin 2023 nga njësi shpenzuese "Aparati i Bashkisë Fushë Arrëz" për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e Pogarive vjetore është mbështetur në Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore

në njësitë e qeverisjes së përgjithshme". I vëryshuar, lidhur me operacionet buxhetore, është rakorduar dhe konfirmuar nga Dega e Thesarit Pukë si dhe nuk ka patur në asnjë rast kontestimin.

• **Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara.**

Bashkia Fushë Arrëz për vitin 2023 ka hartuar Pasqyrat Financiare vetëm njësinë shpenzuese Bashkia Fushë Arrëz pasi nuk ka në varësi njësi të tjera shpenzuese.

• **Afutet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare**

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga NA dhe NZ, si dhe janë të dërguara në Degën e Thesarit Fushë Arrëz për vitin ushtritor 2023 me shkruesë përcjellëse nr. 677 prot., datë 11.03.2024 konfirmuar nga Dega e Thesarit Pukë. Cilëshatë pasqyrat janë ngarkuar dhe në sistemin AFMIS sipas udhëzimit nr. 2, datë 19/01/2022 të MFI.

Në cilësinë e Nënpranësit Autorizues është Kryetari Bashkisë Fushë Arrëz dhe në cilësinë e Nënpranësit Zbatues është Drejtori i Financës.

• **Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.**

Për vitin 2023 nga verifikimi për çdo muaj i ditarit kontabël të bankës sipas natyrës për shpenzimet e klasës 6 dhe klasës 2 me akt rakordimin e thesarit mbi bazë ekstrakthe banko (dokumenti i nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor rezultoi se nuk ka diferencë. Për këtë janë përdorur ditari i bankës i mbajtur sipas natyrës për autorizimet buxhetore (çeljet) dhe përdorimi fondesh sipas llojit të shpenzimeve.

• **Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultati.**

Për ta siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përpulshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen teste në regjistrimet në ditaret kontabël në lidhje me:

- mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbajtësve të tyre;
- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhos dhe të mëvonshëm nëpërmjet:

- shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- kontrollin të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- verifikimin të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditareve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimin të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

• **Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Aparatit Bashkisë**

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Në këtë bashki, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program "Excel".
- Nuk janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.
- Azhurmimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjike dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditaret e bankës, të arkës, magazinës, të pagave etj por nuk janë mbajtur paratë për

llogaritë kreditore e debitore. Nuk është mbajtur libri i madh apo libri centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, duke kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prejja e artikujve kontabël. Gjithashtu nuk është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentat vërtetuese.

- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.

- Plotësimi i dokumentave bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vertetësi veprimin ose ngjarjen, përmban të dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë kryerur dhe ekzekutuar veprimin me të dhënat e nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu: Dokumentat vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrie-dalje, mandat afektimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shpërqëohen nga dokumenta autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentat kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marveshjet etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentat vërtetues të shpenzimit si fakturat, listpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.

- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të guajtur të angazhimeve (nëse në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

• **Baza e dhënies së opinionit të Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së tërësive të pasqyrave financiare.**

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financiare të Bashkisë për aktivitetin ekonomik e financiar 01.01.2023 deri më datën 31.12.2023.

Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Drejtoria e Financës Gjithë fuzës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se, janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në celja për vitin 2023 rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2022.

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2023 rezultoi se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjesë e PP, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike;

Totali i Aktivit për vitin 2022 është në vlerën 1,681,883,752 lekë dhe për vitin 2023 është 1,734,333,986 lekë . i paraqitur në formatin 1 dhe i zbërthyer në llogari sipas aneksit nr. 1 pikë 2 bashkëlidhur projektreportit të auditimit.

A. AKTIVE AFATSHKURTRA.

Klasa 5 "Mjete monetare dhe ekivalente të tyre" në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 393,868,118 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 është në vlerën 448,762,028 lekë, të cilat rakordojnë me rubrikën V "Teprica në fillim të vitit ushtrimor" dhe rubrikën VI "Teprica e likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor" në Formatin nr.3 "Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOW) sipas mendës direkte".

- **Gjendja e llogarive 520 "Disponibilitete në thesar"** sipas bilancit në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 81,576,243 lekë dhe në mbyllje të vitit 2022 është në vlerën 120.407,947 lekë, e cila përfaqësohet nga 5% mbajtur si garanci për punimet e ndërtimit si dhe gjendja e papërdorur e fondeve gjatë vitit 2023 e cila trashëgohet për vitin 2024.

Gjithashtu gjendja e llogarisë 520 "Disponibilitete në thesar" rakordon me realizimin në fakt të fondeve sipas akt-rakordimit me llogarë të Thesarit Pukë për Transferta dhe të ardhurat e

trashëguara nga viti 2022, theksojmë se gjatë vitit 2023 janë krijuar të ardhura për tu përdorur gjatë vitit 2023 sipas tabelës vijuese:

Nr.	Emertimi i Veprimave	Shuma në lekë
1	Grantë të trashëguara nga 2022 (Kapitulli 1)	51,568,073
2	Të ardhura të trashëguara nga 2022 (Kapitulli 5)	20,757,171.02
3	Grant i Akorduar për vitin 2023	93,103,000
4	Shitese Granti për 2023	25,923,480
5	Transfere që trashëgohen nga transferita specifike	
6	Të ardhurat e vitit 2023	22,568,702.5
7	Transferita specifike për vitin 2023	101,810,000
8	Shitese Transferita specifike për vitin 2023	5,018,000
Zëritet:		
-	Shpenzimet faktike Grantë (Kapitulli 1)	86,303,968
-	Shpenzimet faktike Të ardhura (Kapitulli 5)	26,174,239
-	Shpenzimet faktike Granti konkurrues	
-	Shpenzimet faktike Transferita specifike	97,058,591
Mbjetja për përdorim në vitet pasardhëse		111,213,631

Gjendja inventari Qarkullues

Gjendjet e llogarive 32 "Materiale" gjendja në dalje të vitit 2023 gjendet në shumën 9,992,584 lekë (inventare malirap për hashkinë Pushë Arrëz), ndërsa në uehyllje të vitit 2023 kjo llogari gjendet në të njëjtën shumë 10,636,984 lekë. Kjo shumë rakordon me inventarin llogaria 327 "Objekte Inventari" që disponon Bashkia dhe është e analizuar në librin e inventarit.

Llogaria 468 "Debitore të ndryshëm" paraqitet me gjendje në shumën 284,293,539 lekë në fillim të vitit 2023, e cila ka ndryshime gjatë vitit 2023 (shetja dhe pakësime) dhe paraqitet në vlerën 301,181,486 si më poshtë:

Akt kontrole	Kopeshte, Çerdhe	Ish-komunat	tatim taksa	Viti
468	468	468	468	Total
241,372,619	29,300	6,138,384	3,796,562	2023
	32,100		2,780,106	2022
			1,346,302	2021
			25,420,756	2020
			3,599,960	2019
			4,133,294	2018
			2,458,329	2017
			1,017,264	2016
			1,253,430	2015
			1,028,740	2014
			1,860,020	2013
			1,677,900	2012
			3,326,420	2011
241,372,619	51,400	6,138,384	53,619,083	301,181,486

Nga Drejtoria e Financës është mbajtur në mënyrë analitike (sipas njësive të varësisë dhe listave emërore) llogaria 468, e cila në fund të vitit 2023 rezulton me një njëje prej 16,824,947 lekë. Nga verifikimi i kryer rezulton që totali i llogaritë analitike në fund të vitit 2023, kuadron me llogarinë

sintetike në Aktiv të Pasqyrës së Pozicionit Financiar dhe me lëvizjet e llogarinë 468 të pasqyruara në Librin e Madh (Centralizatorin 2023).

Llogaria 4342 "Të tjera Operacione me shtetin (debitor)" paraqitet me gjendje në vlerën 17,700,894 lekë në fund të vitit 2022, ndërsa për vitin 2023 kjo llogari paraqitet në vlerën 14,724,966 lekë.

Këto janë detyrimet e muajit dhjetor të vitit 2023, të cilat likuikohen në vitin 2024, gjendja paraqitet si më poshtë vijon:

421 <i>Paga</i>	431 <i>Tatime</i>	435 <i>Sig.shoq</i>	436 <i>Sig shend</i>	401-408 <i>Shpenzime operative</i>	<i>Investime</i>	<i>Shuma</i>
<i>Dhjetor 23</i>						<i>Viti 2023</i>
10,642,438	389,191	2,936,714	406,961	306,628		
				28,724		
				14,310		
10,642,438	389,191	2,936,714	406,961	349,662	0	14,724,966

a.Tatim mbi pagë llogaria 6001 për vlerën 389,191 lekë, detyrim i muajit Dhjetor 2023.

b.Paga dhe shesa mbi pagë llogaria 6001 për vlerën 10,642,438 lekë, detyrim i muajit Dhjetor 2023.

c.Sigurime Shëqërore llogaria 6010/6011 për vlerën 2,936,714 lekë, detyrim i muajit Dhjetor 2023.

d.Sigurime Shëndetësore llogaria 6010/6011 për vlerën 406,961 lekë, detyrim i muajit Dhjetor 2023.

e.Operative e mirëmbajtje dhe të përgjithshme për vlerën 349,662 lekë, koncretisht llogaria 6022.

Tek kjo llogari është pasqyruar

Tek kjo llogari janë pasqyruar:

-Pagese për FSHL për muajin dhjetor 2023 për vlerën 306,628 lekë.

-Pagesë për Ujësjellës Sha detyrim i muajit dhjetor 2023 për vlerën 28,724 lekë.

-Pagesë për shërbime postare për muajin dhjetor 2023 në shumën prej 14,310 lekë sipas fatures nr. 2271, date 3.1.2024.

II. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Auditimi i aktiveve afatgjata materiale

Objektivat e auditimit të aktiveve afatgjata materiale, janë që të sigurohem: se:

Aktivet ekzistojnë, ato i përkasin subjektit, janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.

2. Kontrollë të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve.

- Për auditimin e aktiveve afatgjata materiale, u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme:

- U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve afatgjata materiale në raport me gjendjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;

- U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhur ndonjë variation anomal mbi aktivet afatgjata materiale;

- U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangjet dhe përjashtimet e veçanta;

- U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranura dhe ndërzimeve përkatëse.

- U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;

- U krahasuan investimet e realizuara gjatë ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet.

3. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e aktiveve afatgjata materiale:

a. Gjatë hyrjes së aktiveve në prorbësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se veprimet janë kryer në zbatim të kërkesave të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

- Për Aktivet e blera janë kryer teste për 5 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nëse janë kontabilizuar sipas vlerës së tyre të marrjes (çmimi të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);

- Për Aktivet e marra falas janë kryer teste për 4 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nëse janë kontabilizuar duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;

- Aktivet e qella në subjekt (kalar kapital) janë kryer teste për 2 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabel nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të shtjelljes.

b. Për inventarin, janë kryer teste për të siguruar që subjekti:

- Procedon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve të saj të qëndrueshme sipas rregullave kontabel përgjithësisht të pranueshme;

- Përdor referencat ose teknikat më të përshtatshme për natyrën e pasurisë (çmimi i tregut, tabelat e publikuara, treguesit specifikë, etj.);

Ka marrëur të njëjta rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin.

Aktivitet Afatgjata Jomateriale (AAJM)

Çenilli e llogarisë 202 "Studime e projekte" në çelje të vitit 2021 gjendet në vlerën 19,692,232 lekë, ndërsa në fund të vitit 2023 rezultoi me këtë vlerë 20,191,432 lekë. Kjo shumë rakordon me inventarin sipas kartelave të personave që kanë në ngarkim. Llogaria 202 "Studime e Projekte" në pasqyrat e pozicionit financiar gjendet në vlerën 20,191,432 lekë vlerë e cila shpreh gjendjen e mbetur progresive ndë vitet.

Ndryshime në këtë llogari paraqiten sipas tabelës së mëposhtme:

Objekti	Shtesa	Pakesime
Projekte teknike të kullujave	499,200	
Totali:	499,200	

Gjatë vitit ushtrimorë kjo llogari nuk paraqet paksim. Vlera neto e kësaj llogarie paraqitet në 12,216,078 lekë.

Llogaria 211 "Pyje, Plantacione", në çelje të vitit 2023 ka qenë në shumën 5,948,353 lekë, ndërsa në mbyllje të ushtrimit për vitin 2023 gjendet në vlerën 5,948,353 lekë. Kjo llogari nuk ka pësuar ndryshime gjatë vitit ushtrimorë.

Kjo shumë rakordon me inventarin sipas kartelave të personave që kanë në ngarkim. Llogaria 211 "Pyje, Plantacione" në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2023 paraqitet në fillim të vitit ushtrimorë me gjendje në vlerën neto prej 5,988,456 lekë e cila nuk paraqet ndryshime gjatë vitit. Nga analiza e kësaj llogarie **konstatohet se nuk është kontabilizuar:**

-Vlera e 394 prunave me sipërfaqe 65,287,847 m² pyje e kullota, të cilat janë regjistruar në ish-ZVRPP Pukë, të evduantuara nga zyra e pyjeve e kullotave të bashkisë. Këto prona janë regjistruar në vitet 2012-2013 nga ish bashkia Fushë Arrëz dhe ish Komuna Qafë Mali.

-Nuk është kryer inventarizimi dhe vlerësimi i pyjeve dhe kullotave me komision të ngritur nga Titullari i Institucionit.

-Në llogarinë nr.211 "Pyje, kullota, plantacione", nuk është pasqyruar vlera e pyjeve dhe kullotave në pronësi të Bashkisë Fushë Arrëz, të transferuara me VKM nr.433, datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkisë të Pyjeve dhe të Kullotave Publike, sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit dhe të ish Komunave/Bashkisë", e ndryshuar,

shënjën nr.49, e cila përmban, listën e inventarit të pyjeve dhe kullotave që transferohen në pronësi të Bashkisë Fushë Arrëz, me numër vendor nga 1 deri 4242, ilustruar për:

-Ekonominë Pyjore Lumëbardhë, me sipërfaqe $3182.43 \text{ Ha} / 31.824.300 \text{ m}^2 \cdot 100 \text{ lekë}^2/\text{m}^2 = 3.182.430.000 \text{ lekë}$

-Për llogaritë e mësipërme në Bashkinë Fushë Arrëz nuk ekziston një regjister kontabël, ku të specifikohet analitiku i llogarisë, data e hyrjes ose marjes në dorëzim, përshkrimi i aktivit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vendndodhjen, personin përgjegjës, vlerën e akumuluar të amortizimit, kohën e shërbimeve të mirëmbajtjes, vlerën e akumuluar të shpenzimeve të mirëmbajtjes, datën e daljes nga pronësia etj. Veprime në kundërshtim me Ligji nr.139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" i ndryshuar, Kap. III, neni 9, pika 1.2 "Të drejtën dhe përgjegjësinë e pronësisë"; Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, pikat 26, 27, 30 dhe 74, dhe Udhëzimi nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", Kap III, pika 30, i ndryshuar.

Llogaria 212 "Ndërtime e konstruksione" në çelje të vitit 2023 ka qenë në shumën: 624,756,804 lekë. Për vitin 2023 kjo llogari gjendet në shumën 657,150,334 lekë, sic shihet gjatë vitit 2023 kjo llogari ka pësuar ndryshime dhe konkretisht ka këtu shtesa në vlerën 32,413,530 lekë, të cilat janë investime të vitit ushtrimore të cilat janë marrë në dorëzim, në mënyrë tabelare si mëposhtë:

Objekti	Shtesa
Rikonstruksion Ndertese Shkolla Mesme Qytet	114,624
Rikonstruksion shkolla e bashkuar Iballë	158,626
Riparim dhe mirëmbajtje objekti për punëkëmbim NJVNRK shërbim për komunitetin EUAM Kod projekti CH55001	588,000
Rikonstruksion mure mbanjese kod projekti 18A/901	31,522,280
Totali:	32,413,530

Kjo shumë rakordon me inventarin e ndërtesave që disponon Bashkia dhe është e analizuar në librin e aktiveve të grupuara për ndërtesat. Llogaria 212 "Ndërtime e konstruksione" në pasqyrat e pozicionit financiar të vitit 2023 në fillim të vitit paraqitet me gjendje në vlerën neto 460,490,157 lekë duke pësuar ndryshime gjatë vitit konkretisht paksime për normat vjetore të amortizimit duke u pasqyruar në vlerën 471,289,268 lekë.

Llogaria 213 "Rrugë, rrjete dhe vepra ujore" në çelje të vitit 2023, ka qenë në shumën 809,244,327 lekë. Për vitin 2023 kjo llogari gjendet në shumën 833,044,761 lekë, sic shihet gjatë vitit 2023 kjo llogari ka pësuar një rritje prej 23,800,434 lekë, të cilat janë investime të vitit të cilat janë marrë në dorëzim, përkatësisht ato paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Objekti	Vlerë
Sistemin arësimi dhe ndriçimi rruga urbane dytesore "Rinia"	13,392,125
Planime rehabilitimi në rrugën e Gjymnazit dhe Rrugën Demokracia	1,582,515
Rikonstruksion Rrugë Përreze	1,139,904
Ndërtim vepra uji (Ura) në rrugët amtoriale, Llogje Arilaj dhe Llogje Likaj Njësia Qyte Mali	2,565,889
Ndërtim Ura Buzjoni	1,140,000
Blerje Shpyllu dhe rikonstruksion rrjeti për ndriçim	1,917,120
Rehabilitim rruga Iballë	1,564,781
Totali:	23,800,434

¹ Përcaktuar në VKM nr 89, datë 03.0.2010 "Për miratimin e hartës së vlerës së tokës në RSH".

Kjo shumë raikordon me inventarin e rrugë, rrjete dhe vepra ujore që disponon Bashkia dhe është e analizuar në librin e aktiveve të trupëzuara. Llogaria 213 "Rrugë, rrjete dhe vepra ujore" në pasqyrat e pozicionit financiar në çelje të vitit 2023 gjendet në vlerën neto 647,682,716 lekë ndërsa në fund të vitit ushtrimorë me gjendje prej 639,099,014 lekë.

Llogaria 214 "Instalime teknike, paisje e vegla" në çelje të vitit 2023 ka qend në shumën 10,798,088 lekë, gjatë vitit 2023 ka patur ndryshime dhe në fund të periudhës paraqitet në vlerën prej 11,168,888 lekë me një shtesë prej 370,800 lekë të cilat janë investime të vitit të cilat janë marrë në dorëzim, përkatësisht ato praqiten në tabelën e mëposhme:

Objekti	Vlera
Motosharre	180,000
Shkallë metalike me 3 hapije	36,000
Aparat gur fiesibel profesional Deçoll	48,000
STIHLBR 600 238mph677 CFM Gas Backpack Leaf Blöë	57,600
Aparat Ap 3	49200
Totali:	370,800

Kjo shumë raikordon me inventarin e instalime paisje e vegla që disponon Bashkia dhe është e analizuar në librin e aktiveve të trupëzuara. 214 "Instalime teknike, paisje e vegla" në pasqyrat e pozicionit financiar në çelje të vitit 2023 gjendet në vlerën neto 6,606,157 lekë ndërsa në fund të vitit ushtrimorë me gjendje prej 6,622,724 lekë

Gjendja e llogarisë 215, "Mjete transporti" në fillim të vitit 2023 gjendet me shumën 19,250,835 lekë, gjatë vitit 2023 nuk ka patur ndryshime dhe në fund të periudhës paraqitet në vlerën prej 19,250,835 lekë. Nga analiza e kësaj llogarie konstatohet se është e analizuar në librin e aktiveve të trupëzuara. Llogaria 215, "Mjete transporti" në pasqyrat e pozicionit financiar në çelje të vitit 2023 gjendet në vlerën neto 10,389,674 lekë ndërsa në fund të vitit ushtrimorë me gjendje prej 8,311,738 lekë

Gjendja e llogarisë 218 "Inventar ekonomik" në fillim të vitit 2023 është në shumën 28,533,669 lekë, sic shihet në mbyllje të vitit ushtrimor kjo llogari gjendet në vlerën 33,228,241 lekë. shtesat gjatë vitit 2023 në këtë llogari ka pësuar një rritje prej 4,694,572 lekë, përkatësisht këto janë shtesa pa dhe me pagesë gjatë vitit 2023 Paisje kompjuterike të cilat i janë dhuruar nga ZVA Pukë, Shkollës Iballë dhe Shkollës së Mesme Fushë Arëz me dokument shoqërues, Shkresa nr. 180, date 30.8.2023 si dhe Flete dalje nr.4 & 6, date 25.8.2023. Kjo shumë raikordon me inventarin ekonomik që disponon Bashkia dhe është e analizuar në librin e aktiveve të trupëzuara. Llogaria 218 "Inventar ekonomik" në pasqyrat e pozicionit financiar në çelje të vitit 2023 gjendet në vlerën neto 17,098,552 lekë dhe në mbyllje të vitit 2023 gjendet në vlerën 20,844,680 lekë, vlerë e cila shpreh gjendjen e mbetur pas amortizimit.

Gjendja llogaria 219 "Amortizimi" në çelje të vitit 2023 gjendet në shumën -357,064,034 lekë, pas llogaritjes së amortizimit për aktivet që disponon Bashkia Fushë Arëz dhe shtesat/pakësimet gjatë vitit 2023 kjo llogari gjendet në vlerën -416,510,886 lekë,

Llogaria	Gjendja në fillim	Shtesa	Gjendja në fund
219.11	-859,897	0	859,897
219.21	-164,246,647	21,614,419	-185,861,068
219.21	-161,561,671	32,384,136	-193,945,747
219.41	-4,191,931	354,231	-4,546,164
219.51	-8,861,761	2,077,936	-10,939,097
219.81	-11,433,117	948,444	-12,381,561

219.91	5,907,670	3,067,684	-7,975,354
--------	-----------	-----------	------------

Testi substancial i amortizimit

Amortizimi i AQ të Trupëzuara dhe të Patrupëzuara është llogaritur sipas rrethave ligjore të miratuara në përputhje me UMT nr.8, datë 9.3.2018“Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme” pika 36.

Përllogaritja është bërë mbi vlerën neto në celje të periudhës ashurimore për aktiv sipas klasifikimit.

Gjendja llogaria 231 “Shpenzime për Rritjen e AQT në proces” në celje të vitit 2023 gjendet në vlerën 3,975,360 lekë, gjatë vitit 2023 ka pasur zhvritje të kësaj llogarie pasi janë likuiduar dhe marrë në dorëzim dy objektet e papërfunduara në vitin 2022. Kjo llogari paraqitet në vlerën 0.

Objekte në këtë llogari që i përketin dy investimeve të mbetura në proces në fund të periudhës kontabël paraqet në cilat paraqiten përkatësisht sipas tabelës së mëposhtme:

Objekti	Kod projekti	Vlera
Ndërtimi i lagje aritaj dhe lokaj LB 7046, Kod projekti 1550095 Dini i shpk.kance 15 ite 16.12.2022	1550095	2462892
Publike rehabilitimi i rrugë e gjimnazit dhe demokracia LB 7053, Kod projekti 1550098 Dini i shpk.kance 34 date 16.12.2022	1550098	1512468
Totali		3,975,360

Kjo shumë rrekordon me inventacin llogaria 231 “Shpenzime për Rritjen e AQT në proces” që disponon Hashkia dhe është e analizuar në librin e aktiveve të trupëzuara.

3.Nënrubrika aktive afatgjata financiare,

Aktive Afatgjata Financiare rezultojnë në fund të vitit 2023 me vlerën 122,100,000 lekë dhe në fund të vitit 2022 në vlerën 122,100,000 lekë, siç shihet edhe në Pasqyrën e Pozicionit Financiar të paraqitur më poshtë:

Nr. Reshti	Referenca e Llogarive	EMERTIMI	Ushtrimi i Mbyllur	Ushtrimi Paraqortës
59	25-26	3. Aktive Afatgjata Financiare	122,100,000	122,100,000
60	25	Husadhitie e Ncshuadhitie	0	0
61	26	Pjesmarje në kapitalin e vet	122,100,000	122,100,000

Rrethm. Bashkën Fushë Arrez

Nga analiza e llogarisë 26 “Pjesmarje në kapitalin e vet” në celje të vitit 2023 gjendet në vlerën 122,100,000 lekë, gjatë vitit 2023 nuk ka pasur rritje të kësaj llogarie dhe në fund të periudhës kontabël paraqitet në vlerën 122,100,000 e cila ka të bëjë me me aksionet të pjesjellës kanalizime.

PASIVET (DETYRIMET)

Pasivet Afatshkurtra

Shuma e llogarisë sintetike të klases 4 “Detyrimet afatshkurtra” është e barabartë me gjendjen e llogarisë 4342 “Të tjera operacione me shëtit (debitor) në aktivin e bilancit.

Llogaria 401-408 “Furnitorë e llogari të lidhura me të” në celje të vitit 2023 paraqitet në vlerën 1,108,596 lekë ndërsa në mbyllje të vitit 2023 paraqitet në shumën 349,662 lekë ndryshe nga viti i kaluar kjo llogari ka rritje pasi ka likuidime të detyrimeve të prapambetura. Kjo llogari ka detyrime ndaj të tretëve, si vijon:

a. Pagese për FSHH për muajt Dhjetor 2023 për vlerën 306,628 lekë.

b. Pagesë për Ujësjellës Sha detyrim i muajt Dhjetor 2023 për vlerën 28,724 lekë.

e. Pagesë për shërbime postare për muajin dhjetor 2023 në shumën prej 14,310 lekë sipas faturës nr. 2271, datë 3.1.2024, Këto janë fatura të muajit Dhjetor 2023 të cilat janë likuiduar në vitin 2024.

Gjendjet e llogarive 421 "Personeli e llogari të lidhura me to", në mbyllje të vitit 2023 është në shumën 10,642,438 lekë, shumë e cila përbën shumën e listpagesave të muajit Dhjetor të vitit 2023.

Llogaria 431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim-taksa", në mbyllje të vitit 2023 është në shumën 389,191 lekë, shumë e cila përbën shumën e listpagesave të muajit Dhjetor të vitit 2023.

Llogaria 435 "Sigurime shoqërore dhe shëndetësore" në mbyllje të vitit 2023 është në shumën 2,936,714 lekë, shumë e cila përbën shumën e listpagesave të muajit Dhjetor të vitit 2023.

Llogaria 436 "Sigurime shëndetësore" në mbyllje të vitit 2023 është në shumën 406,961 lekë, shumë e cila përbën shumën e listpagesave të muajit Dhjetor të vitit 2023.

Llogaria 466 "Kreditor për mjetet në ruajtje", rakorduar me degën e thesarit, është analizuar analitikisht për çdo kreditor në lidhje me ngarkesimin e 5% të garancisë së punimeve të kryera për investime e cila në fillim të periudhës ishte në vlerën 9,250,997 lekë, ndërsa në fund të periudhës paraqite në vlerën 9,194,316 lekë, kjo vlerë paraqitet në anesin nr. 2 pika 2 bashkëlidhur projekt raportit të auditimit.

Nga analiza e kësaj llogarie rezultoi se vlera në fund të vitit 2023, ka pasur në përbërje të llogarisë detyrime për garancit punimesh të bashkisë ndaj subjekteve private, garancit këto të cilave u ka kaluar afati i përcaktuar në kontratat përkatëse të investimit dhe përsëri janë akoma gjendje në llogarinë 466 për të cilat nuk janë urren subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të likuiduar vlerën e garancisë, të cilave ju ka kaluar afati i përcaktuar në kontratë dhe investimi për të cilën është mbajtur garancia është marrë në dorëzim në kundërshtim me Udhëzimin nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në Njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", i ndëryshuar, pika 3.2 "Trajtimi kontabël dhe funksionimi i llogarive të të tretëve (klasa 4) - funksionimi kontabël i llogarive të tjera të klasës 4".

Rezultati i shktrimit i pasqyruar në llogarinë 85 për vlerën 111,213,631 lekë dshte e kuadruar me akt-trashëgiminë e mbajtur në degën e thesarit në mbledhjetje të Ligjit Për Buxhetin e vitit 2023, ligjit Nr.139, Dt. 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjit Nr.68/2017 "Për funksionin e vetëqeverisjes vendore", udhëzimit të ministrit të Financave udhëzimit Nr.9, datë 20.03.2018 "Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit", theksojmë se gjatë vitit 2023 janë krijuar dhe përdorur të ardhura gjithsej sipas tabelës së mëposhtme:

Nr.	Emërtimi i Veprimave	Shuma në lekë
1	Grante të trashëguara nga 2022 (Kapitulli 1)	51,568,315
2	Të ardhura të trashëguara nga 2022 (Kapitulli 5)	20,757,171.02
3	Grant i Akorduar për vitin 2023	91,105,000
a1	Shtesë Granti për 2023	25,923,488
a2	Investime që trashëgohen nga transfera specifike	
a	Të ardhurat e vitit 2023	22,568,703.5
5	Transfera specifike për vitin 2023	101,810,000
a2	Shtesë Transfera specifika për vitin 2023	5,018,000
Zbiter:		
-	Sipërzimet faktike Grante (Kapitulli 1)	86,105,968
-	Sipërzimet faktike Të ardhura (Kapitulli 5)	26,774,239
-	Sipërzimet faktike Grant konkurrues	
-	Sipërzimet faktike Transfera specifike	97,018,591

Durimi: Drejtoria e Financës

Auditimi mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës publike (Aseteve dhe Pyjeve Kullotave) të transferuara sipas VKM.

Në zbatim të pikës 3 mbi “Auditim mbi organizimin dhe funksionimin e strukturave mbi administrimin e pronës publike(aseteve, pyje dhe kullota)”, të programit të auditimit nr. 623/1 datë 09.05.2024 për auditimin financiar ushtruar në Bashkinë Fushë-Arrëz, janë administruar evidencat si mëposhtë:

- Lista e pasurive të paluajtshme të transferuar në Bashkinë Fushë-Arrëz
- Lista e pasurive të paluajtshme të regjistruar në kadastrë
- Inventari i fondit pyjor
- Kartatat e ldhura për dhënie me qira të fondit pyjor

1. PASURITË E PALUAJTSHME

3.1. Auditim mbi procedurën e inventarizimit dhe regjistrimit të tyre në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës

Sipas ligjit nr.8744, datë 22.02.2001 “Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësi të qeverisjes vendore”, që nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji, bashkitë ishin të detyruara të paraqisnin në Këshillin e Ministrave listën e pronave që kërkonin t’u transferoheshin, një proces që përfshinte hartimin e inventarit paraprak, afishimin dhe përditësimin e pasurive dhe në fund miratimin e listës përfundimtare të pronave me vendim të Këshillit të Ministrave,

	Bashkia/Njësi	Nr. Pronave në Inventar	Në pronësi	Në përdorim	Prona të regjistruara në Kadastrë
1	Bashkia Fushë-Arrëz	114	7		Nuk ka listë përfundimtare
2	Njësia administrative Fierzë				Nuk ka listë paraprake në përfundimtare
3	Njësia administrative Hecaj				Nuk ka listë paraprake në përfundimtare
4	Njësia administrative Qafë Kallë				Nuk ka listë paraprake në përfundimtare
5	Njësia administrative Fushë				Nuk ka listë paraprake në përfundimtare
	Totali				

Për bashkinë Fushë-Arrëz, përfshirë ish komunat aktualisht njësi administrative, konstatohet se nuk është miratuar lista përfundimtare e pasurive të paluajtshme. Konkretisht, me VKM nr 1176 datë 20.08.2008 është miratuar lista paraprake e inventarit të pronave, me qëllim afishimin e tyre dhe përditësimin e ndryshimeve në listën përfundimtare të pronave. Në këtë inventar të hartuar nga Bashkia Fushë-Arrëz nuk janë përcaktuar zonat kadastrale dhe numrat e pasurive për identifikimin e pronave. Në këtë inventar paraprak janë përfshirë pasuri sipas fushës së përdorimit:

- Pyje, me numër rendor nga 1-90
- Arsimi, me numër rendor 91-97
- Shëndetësi, me numër rendor 98-99
- Shërbim social, me numër rendor 100-101
- Zivillim ekonomik, me numër rendor 102-104
- Bujqësi dhe ekonomik, me numër rendor 105-114

Në lidhje me pronat **në fushën e arsimit** rezultojnë pasuritë si mëposhtë:

Lloji i pronës	Emri	Sip. totale m ²	Sip. totale ndërtuesë m ²	Investime
Tuale+Ndërtuesë	Kopshti i fëmijëve	700	564	Proces rikonstruksioni
Tuale+Ndërtuesë	Shkollë 9 vjeçare qytet Fushë Arëz	4262	2640	Rikonstruksion plotë
Tuale+Ndërtuesë	Shkollë 9 vjeçare Muzoj	1200	604	Jo
Tuale+Ndërtuesë	Shkollë fillore L. Linaudës	462	99	
Tuale+Ndërtuesë	Shkollë fillore Fshat Fushë Arëz	637	503	
Tuale+Ndërtuesë	Konvikti	800	1540	Degraduar
Tuale+Ndërtuesë	Shkollë e Mesme qytet Fushë Arëz	2100	1310	Rikonstruksion

Në lidhje me pronat **në fushën e shëndetësisë** rezultojnë pasuritë si mëposhtë:

Lloji i pronës	Emri	Sip. totale m ²	Sip. totale ndërtuesë m ²	Investime
Tuale+Ndërtuesë	Ambulancë, fshat Fushë Arëz	60	58	Vlerë 1 kat. Gjatë rikonstruksionit
Tuale+Ndërtuesë	Qendra shëndetësore Fushë Arëz	1152	1057	

Në lidhje me pronat **në fushën e shërbimit social** rezultojnë pasuritë si mëposhtë:

Lloji i pronës	Emri	Sip. totale m ²	Sip. totale ndërtuesë m ²	Investime
Tuale+Ndërtuesë	Cerche fëmijësh	195	260	
Tuale+Ndërtuesë	Cerche e vjetër e fëmijëve	895	760	

Në lidhje me pronat **në fushën e zhvillimit ekonomik** rezultojnë pasuritë si mëposhtë:

Lloji i pronës	Emri	Sip. totale m ²	Sip. totale ndërtuesë m ²	Investime
Tuale+Ndërtuesë	Ish-fabrika e Shatave	2100	1400	
Tuale+Ndërtuesë	Tregu i qytetit	412	462	
Tuale+Ndërtuesë	Ish-fabrika e tiorës			

Për pasurinë ish-fabrika e fibrës,në inventarin e pasurisë nuk është përcaktuar zëri kadastral numri i pasurisë, sipërfaqja e trualit dhe objektit. Me aplikimin nr.45250 datë 18.12.2023. Bashkia Fushë-Arëz ka kërkuar informacion mbi statusin juridik të kësaj prone.

Me urdhrin nr.583 datë 01.12.2023 të Kryetarit të Bashkisë është ngritur grupi i punës i përbërë nga 4 anëtarë për përgatitjen e dokumentacionit për procedurën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme të bashkisë, për të cilën janë ngarkuar sektori i urbanistikës, sektori i financës dhe specialisti i kadastrës. Por, zbatimi i këtij urdhri nuk mund të realizohet në kushtet kur Bashkia Fushë-Arëz dhe ish-komunitat që i janë bashkuar territorit administrativ të saj nuk kanë të miratuar inventarin përfundimtar me Vendim të Këshillit të Ministrave e si pasojë në mungesë të këtij akti, ASHK nuk mund të kryejë regjistrime bazuar në listën e inventarit paraparak.

1.1.Regjistrimi i pronave të përfituara nga investimet

Nga auditimi është konstatuar se për pasat të paluajtshme të ndërtuara me investime nga Bashkia Fushë-Arëz për periudhën 2015-2023 janë gjithasj dy objekte të cilat nuk janë regjistruar në regjistrat e pasurive publike:

- Palestra e shkollës së mesme, me sipërfaqe 458 m² me vlerë investimi 40,554,052 lekë, shtrihet në pasurinë me nr.51, vol.3 faqe 245 me sipërfaqe 3890 m² trual në pronësi shtet. Ky objekt është

ndërtuar me leje ndërtimi nr.6 datë 03.07.2019 për Bashkinë nuk ka regjistruar truallin funksional të objektit e për njëdhajë nuk mund të realizohet regjistrimi në kadastrë.

- Godina e njësisë administrative Bletim me sipërfaqe 118.8 m² me vlerë investimi: 5,628,894 lekë nuk ka leje ndërtimi si dhe nuk ka asnjë informacion juridik për statusin e truallit ku është zhvilluar ndërtimi për njëdhajë nuk mund të realizohet regjistrimi në kadastrë.

Për Bashkinë Fushë-Arrëz

Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se në Bashkinë Fushë-Arrëz nuk administrohet baza e të dhënave të pasurive të paluajtshme të ish-komunave, aktualisht njësi administrative, në formatin e një regjistri të integruar të inventarit të pronave të bashkisë. Ushtrimi i funksioneve në lidhje me inventarin dhe regjistrimin bëhet vetëm përmes një specialisti dhe nuk ka një strukturë të posaçme funksionale me qëllim mbulimin e një fushe komplekse sikurse është inventari i pasurive të paluajtshme.

Nga verifikimi i evidencave, rezulton se:

- Bashkia Fushë-Arrëz dhe ish-komunat që i janë bashkuar tërësisht administrativ të saj nuk kanë të miratuar inventarin përlundimtar në Vendim të Këshillit të Ministrave e si pasojë në mungesë të këtij akti, ASHK nuk mund të kryejë regjistrime bazuar në listën e inventarit paraprak. Inventarët e pasurive të paluajtshme nuk përfaqësojnë një pasqyrë reale të gjendjes faktike të këtyre pasurive, për shkak se nga ana e Bashkisë Fushë-Arrëz nuk është rakorduar me Drejtorinë Vendore të ASHK-së mbi statusin juridik dhe tjetërsimin e mundshëm të pronave nga persona të tretë, përmes procedurave të legalizimit, privatizimit, vendimet e kthimit/kompensimit apo vendimet gjyqësore. Si njëdhajë, inventari rezultoi i papërditësuar në kundërshtim me nenin 37, të ligjit nr.20/2020 "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", ku përcaktohet se "bashkitë kanë për detyrë të kryejnë përditësimin e plotë të pronave të inventarizuara apo të transferuara në favor të tyre brenda 18 muajve nga data e hyrjes në fuqi të këtij ligji. Procedura e përditësimit mbështetet në verifikimin e gjendjes faktike të pronës, nëpërmjet evidentimit në terren dhe verifikimit juridik, që kryhet me asistencën apo pjesëmarrjen e ASHK-së. Po ashtu, bashkia i kërkon ASHK-së informacion të plotë për gjendjen e pronësisë, sipas dokumentacionit që kjo e fundit administroi, përfshirë edhe informacionin për proceset e tjera tranzitore të parashikuara në këtë ligj"

- Nga verifikimi i dokumentacionit rezulton se në Bashkinë Fushë-Arrëz nuk administrohet baza e të dhënave të pasurive të paluajtshme të ish-komunave, aktualisht njësi administrative, në formatin e një regjistri të inventarit të pronave të bashkisë. Ushtrimi i funksioneve në lidhje me inventarin dhe regjistrimin bëhet vetëm përmes një specialisti dhe nuk ka një strukturë të posaçme funksionale me qëllim mbulimin e një fushe komplekse sikurse është inventari i pasurive të paluajtshme.

- Nga Bashkia Fushë-Arrëz nuk është krijuar struktura e posaçme e bashkëpunimit me drejtorinë përkatëse të ASHK-së, të cilat rakordojnë ndënjatë tyre, me qëllim realizimin e procedurave të parashikuara nga neni 37, i ligjit nr. 20/2020, "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë", sikurse parashikohet në VKM nr.28 datë 27.01.2023 "Për përcaktimin e procedurave të hollësishme të përditësimit të listave të pronave shtetërore dhe rregullave të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve".

II.Fondi Pyjor

3.2. Auditimi mbi procedurat e dhënies me qira dhe likuidimin e kontratave të lidhura

Bashkia Fushë-Arrëz ka në administrim një fond pyjor dhe kullësor prej 45,667.54 ha. Lista e inventarit të pyjeve dhe kullotave është miratuar në VKM nr.433 datë 08.06.2016 "Për transferimin në pronësi të Bashkiave të pyjeve dhe të kullotave publike sipas listave të inventarit dhe aktualisht në administrim të Ministrisë së Mjedisit e të Ish-Komunave/Bashkiave", ndryshuar me VKM nr 154 datë 3.3.2021 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin nr.433/2016.

Nr.	Ekonomia pyjore	Forma e planit			Përdorimi i territorit (ha)			Sip. Totale (ha)
		Mbarështimi	Inventarizim	Viti	Pyll	Kullota	Impeditive	
1	Lag		x	1985	2141.64	9.12	17.55	2168.31
2	Lumardhe	x		2001	1182.44	136.95	82.47	1401.87
3	Goske 1		x	1985	2831.77	51.35	154.57	2937.69
4	Goske 2			1985	216.42	0	8.18	224.6
5	Siriqa 1	x		1974	1055.39	0	123.86	1179.25
6	Siriqa 2			1974	187.46	0.63	78.92	227.01
7	Kuçi - Bushat	x		1991	840.56	0	44.71	885.27
8	Qelaz		x	1985	568.57	0	37.42	605.99
9	Qale place - Qale shuri	x		2002	1673.45	14.33	196.16	1994.94
10	Lumi i Berushes	x		1975	1850.65	18.58	83.72	1952.95
11	Ibaile-Mzi. 1 pjesa Iballle	x		1988	1306.7	219.08	310.43	1536.21
12	Ibaile-Mzi. 2 pjesa Mzi			1988	1806.28	14.65	377.86	2198.79
13	Brup - Drini	x		1979	5444.43	11.31	655.44	6111.18
14	Kryezi - Murg		x	1985	2170.03	0.64	144.19	2315.86
15	Lumi i Zi		x	1985	537.53	0	48.97	586.5
16	Kryezi	x		1988	2506.4	58.33	7.94	2572.67
17	Dardhe - Qebik	x		2002	3217.03	1.26	30.25	3248.54
18	Sakatask Drini	x		1990	3230.26	4.55	296.86	3531.67
19	Martur - Chiri		x	1985	2239.36	2.96	165.66	2407.98
TOTALI		10	5		41239.37	586.15	3542.05	45667.57

Nga auditimi ka rezultuar se:

- Në lidhje me menaxhimin e fondit pyjor, sipas detyrimeve të nenit 17 të ligjit nr.57/2020 "Për Pyjet", Bashkia e Fushë-Arrëz nuk ka hartuar plane mbarshtimi për ekonomitë pyjore.
- Në kundërshtim me pikën 66 të VKM nr 443/2016 nuk ka regjistruar në regjistrin kadastralë sipërfaqet e fondit pyjor dhe kullorës publik. Në Zyren Vendore të ASHK Pukë rezultojnë se janë çelura kartela të pasurive të pallogjshme për 3217 pasuri pyje dhe kullote, për të cilat Bashkia e Fushë-Arrëz nuk ka aplikuar për certifikatë pasurie, me arsyetimin për mungesë fondesh të planifikuara për këtë qëllim.

Me VKM nr 60 datë 26.01.2022 "Për Shpalljen e ekosistemeve natyrore Rezervat Natyror i Menaxhuar / Park Natyror (Kategoria IV) si dhe miratimin e ndryshimit të statusit të sipërfaqeve ekzistuese të zonave të mbrojtura mjedisore që i përkasin kësaj kategorie" dorëzuar ADJM Shkodër, nga totali i një sipërfaqeje prej 49,304.24 Ha pyje/kullota është zbritur sipërfaqja 3,636.70 Ha e zonave të mbrojtura, e si rrjedhojë vetëm 45,667.54 ha kanë mbetur në administrim të Bashkisë. Në lidhje me ngritjen e bazës së të dhënave për regjistrin kombëtar të fondit pyjor në sistemin ALFIS, me shkresë nr.686 datë 09.03.2023, Bashkia e Fushë-Arrëz i ka kërkuar Agjencisë Kombëtare të Pyjeve kredencialet dhe manualin për përdorimin e sistemit dhe trajtimin e specialistëve të pyjeve.

Marrë shtesë nga mungesa e aksesit në ALFIS, Drejtoria e Shërbimit Pyjor nuk ka shpërndarë të dhënat periodike, mujore apo vjetore për gjendjen e fondit pyjor. Me shkresë nr.1547 datë 21.02.2023, nga Agjencia e Kombëtare e Pyjeve është përcjellë informacioni se hartat në sistemin ALFIS janë hartuar në vitin 1985 dhe vetëm me hartimin e një plani të ri mbarshtimi do të krijohet baza për ekonominë pyjore të inventarizuara dhe azhuruara me hartat që pasqyrojnë gjendjen dhe propozimet për menaxhimin e qëndrueshëm të fondit pyjor për 10 vitet në vazhdim.

Për vitin 2023 është lidhur vetëm një kontratë qiraje me nr.prot 1167 datë 19.04.2023 për dhënie në përdorim të fondit pyjor me shoqërisë "KMV" sh.p.k për "Enjë elektrike dhe sipërfaqe

ndihmëse në funksion të implantit eolik". Objekti i kësaj kontrate është dhënia në përdorim e një sipërfaqe prej 8.0345 ha, nga e cila 732345 ha/4 823 km linjë elektrike+0.8 ha sipërfaqe pyjore, që shtrihen në ekonominë pyjore (ballë-Mezi, Lumi i Berishës, Qafë Plakë -Qafë Sharr, me vlerë 1,076,982 lekë, e cila është paguar.

Përlllogaritja e tarifave për përdorimin e fondit pyjor për ndërtimin dhe përdorimin e kanalit të mbjllor dhe tubacionit është bërë në përputhje me VKM nr 559 datë 29.07.2022 "Për përcaktimin e çmimeve dhe tarifave për dënimin në shfrytëzim/përdorim të fondit pyjor kombëtar për veprimtari ekonomike si dhe për prodhimet drusore dhe jo drusore pyjore.

Lloji	Përlllogaritja	Vlera
Trungshtrë	0.8*210,000 lekë	168,000 lekë
Trungshtrë	1.766 km*210,000 lekë	370,860 lekë
Cungishtrë,140	2.815 km*176,000 lekë	495,440 lekë
Kullotë	0.242*176,000 lekë	42,592 lekë
Total:		1,076,892 lekë

Në lidhje me debitoret nga kontratat e qirasë, për vitin 2023 rezultojnë 7 subjekte në vlerën 2,119,232.5 lekë, përfishirë kamatë/vonesat.

KONTRATAT QIRAVE 2023 (aktive)								
N R	KOHJA E QIRASË	DEBITORI	KLSH	DEBIT	DEBIT	DEBIT	DEBIT	DIFERENCA
1	ABIELECOM SH.AJONË	Anter	31.000					314.000
2	BEKIMI BEKIMI ENERGETIK	LEC	21.000					21.000
3	TRUMI	HE	212.250					212.250
4	LENERGI	HE	917.875					917.875
5	OSKELA	Anter	82.075					82.075
6	ONE ALBANIA	Anter	317.500		28.335	289.165	730.675	413.175
7	VODAFONE ALBANIA	Anter	35.000					35.000
	TOTAL		2,163,240				2,163,240	2,119,232.5

Për subjektet rezultojnë të dhënat si mëposhtje:

- Subjekti "Abielecom" sh.a , "Bekimi" sh.p.k dhe "Oskela" sh.p.k rezultojnë debitor vetëm për vitin 2023
- Subjekti "Trumi Energy dhe Vodafone" ka likuiduar as vitin 2022
- Subjekti "One Albania" ka dëbi për vitin 2023

4 Auditimi i zbatimit të rekomandimeve të lëna në auditimet e mëparshme

4.1. Hartimi i programit (Plan veprimi) me persona përgjegjës dhe respektimi i afatit 20 ditor për zbatimin e rekomandimeve

4.2. Realizimi i programit (plan veprimi) e raportimi në KLSH për ecurinë e zbatimit të rekomandimeve brenda afatit 6 mujor.

4.3. Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm

Vergjithësi e zbatimit të rekomandimeve të dërguara me Bashkimë Fushë Arrez nga KLSH me shkresën nr.871/12 prot datë 24.01.2024.

Nga vecëlërimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve në mënyrë të përmblodhur zbatimi i rekomandimeve paraqitet si më poshtë:

Nga verifikimi i dokumentacionit për zbatimin e rekomandimeve konstatohet se janë rekomanduar gjithsej:

a. Për përmirësimin e gjendjes janë rekomanduar 15 masa organizative nga të cilat janë pranuar plotësisht 15 masa, nga të pranuarat janë zbatuar 2 masa, janë në proces zbatimi 10 masa organizative, dhe janë zbotuar pjesërisht 3 masa

b. Masa për eliminimin e efekteve negative financiare të konstatuara në administrimin e jundeve publike me ekonomicitet, eficiency dhe efektivitet, janë rekomanduar 2 masa, të cilat janë pranuar. Të dy masat janë zbatuar.

c. Masa për orëtimin e të ardhurave të manguara, janë rekomanduar 2 masa, të cilat janë pranuar. Është zbatuar pjesërisht 1 masë dhe 1 masë është pa zbatuar.

d. Masa disiplinore, i janë rekomanduar Kryetarit të Bashkisë Fushë Arrëz dhënia e masës disiplinore ndaj 5 personave. Është ngritur Komisioni Disiplinor, janë dërguar njoftimet punonjësve për të cilët është kërkuar masë disiplinore. Për 3 punonjës janë marrë maset disiplinore, për 1 punonjës nuk është marrë masa pasi rezultoi se është marrë 1 herë masë e cila është në fuqi, dhe për 1 punonjës rezultoi se nuk është më në marrëdhënie pune me Bashkinë Fushë Arrëz.

Drejtimet e Auditimit

1. Hartimi i programit (Plan veprimi) dhe respektimi i afatit prej 20 ditë për kthimin e përgjigjes për zbatimin e rekomandimeve, siç është përcaktuar në nenin 15 shkronja (j) të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

- Nga verifikimi rezultoi se KLSH ka dërguar në Bashkinë Fushë Arrëz rekomandimet e auditimit me shkruesin e saj nr. 871/12 datë 24.01.2024, ndërsa nga Bashkia Fushë Arrëz për zbatimin e rekomandimeve të KLSH nuk është kthyer përgjigje brenda afatit 20 ditore.

Pa zbatuar

2. Respektimi i afatit ligjor prej 6 muajsh nga data e marrjes së njoftimit të raportit të auditimit, për raportimin në KLSH, të caktuar së zbatimit të rekomandimeve të lëna nga auditimi i mëparshëm (pika 2 e nenit 30 të ligjit nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit".

- Nga verifikimi rezultoi se KLSH ka dërguar në Bashkinë Fushë Arrëz rekomandimet e auditimit me shkruesin e saj nr. 871/12 datë 24.01.2024 dhe duhet të raportonte në KLSH brenda 6 muajve ose brenda datës 24.07.2024 (referuar nenit 30, pika 2 e ligjit nr. 154 datë 27.11.2014 "Për funksionimin dhe organizimin e KLSH, për raportimin brenda 6 muajve nga marrja e njoftimit të RPA). Nuk është plotësuar akoma afati i raportimit.

Në proces zbatimi

3. Mbi raportimin rregullisht në Këshillin Bashkiak të caktuar të zbatimit të rekomandimeve të KLSH, siç përcaktohet në nenin 50 "Auditimi i jashtëm, pika 5, të ligjit nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore".

- Nga verifikimi rezultoi se Bashkia Fushë Arrëz nuk ka hartuar planin e veprimi të zbatimit të rekomandimeve të dërguara nga KLSH si dhe nuk ka raportuar në Këshillin e njësisë (Këshillin bashkiak). Në mbështetje me ligjin nr. 68/2017, datë 27.04.2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore", Neni 50-Auditimi i jashtëm ku përcaktohet se; 5. Për të gjitha raportet e auditimit të jashtëm, të kryera nga Kontrolli i Lartë i Shtetit apo auditues të tjerë ligjorë, kryetari i njësisë së vetëqeverisjes vendore përgatit një plan veprimi për zbatimin e rekomandimeve të raportit të auditimit dhe raporton rregullisht në Këshillin e njësisë për progresin në zbatimin e tij."

Pa zbatuar

Statusi i rekomandimeve të lëna në auditimin e mëparshëm:

A. MASA ORGANIZATIVE

1.1 Rekomandimi: Sektori i Financës, në bashkëpunim me Ekspert e Menaxhimit të Programeve, të kryejnë një proces planifikimi të buxhetit në mënyrë të kujdesshme, si dhe të rishikuar përgjatë vitit, mbi bazë nevojash dhe mundësish realizimi, si për investimet ashtu edhe për shpenzimet për mallra e shërbime.

Nga verifikimi rezultoi se: Për vitin 2023, buxheti fillestar i vitit në bazë të vlerësuar të të ardhurave dhe të transferave të pakushtëzuara, është miratuar me vendim të KB me nr. 54, datë 30.12.2022, konfirmuar nga Prefekti i Qarkut Shkodër, me shkresën nr. 9401/2023. Buxheti fillestar është miratuar për vlerën 339,659 mijë lekë, janë bërë shtesa gjatë vitit 2023 në vlerën 70,445 mijë lekë. Shpenzimet operative janë realizuar në masën 65%, me tjetë 3% nga viti 2022, dhe shpenzimet për investime janë realizuar në masën 67%, ose 14% në shtesa se vitin 2022.

Në proces zbatimi

2.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Sektorin e Taksave dhe të Ardhurave Vendore, të marrin masa për ngritjen e një grupi pune për fillimin e identifikimit të të gjithë abonentëve familjarë dhe bizneseve, në koordinim me zyrën e Gjendjes Civile dhe çdo agjent tjetër tatimor të cilët kanë të dhëna për këto subjekte, në mënyrë që planifikimi dhe realizimi i të ardhurave nga kjo Bashki të jetë sa më real. Për këtë, nëse da të jetë e nevojshme, të kërkohet edhe ndihma dhe bashkëpunimi i grupeve të punës të cilët kanë realizuar censusin në territorin e kësaj Bashkie. Të gjithë të dhënat të mbahen manualisht edhe në regjistrat fizikë, krahas atyre elektronikë.

Nga verifikimi rezultoi se: Për vitin 2023, janë planifikuar 28,555 mijë lekë, dhe janë realizuar 22,568 mijë lekë, ose në masën 79%, duke mos u realizuar vlera 5,987 mijë lekë ose 21%. Krahasuar me treguesit e vitit 2022, kemi një përmirësim të të ardhurave në vlerën 1,871 mijë lekë, ose 7%. Rezulton se të ardhurat e mbledhura nga Taksat e mpreteve të përdorura është në vlerën 3,814 mijë lekë, e cila ka ndikuar në rritjen e të ardhurave, kjo si rezultat i bashkëpunimit me DPSITPR.

Në proces zbatimi

2.2 Rekomandimi: Zyra e Taksave dhe të Ardhurave Vendore, në bashkëpunim me Zyrën Juridike, të marrin masa që për aq sa është e mundur të identifikohet, të fillojë procedura e marrjes së masave shtrënguese për vjeljen e të ardhurave të munguara, nëpërmjet bllokimit të llogarive, kallëzimeve penale apo mënyrave të tjera që parashikon legjislacioni në fuqi.

Nga verifikimi rezultoi se: Zyra e Taksave dhe të Ardhurave Vendore, si dhe Zyra Juridike, rezultoi se janë njoftuar vetëm me njoftimet për shlyerjen e detyrimeve vendore, por nuk është marrë asnjë masë tjetër shtrënguese në vijim ndaj subjekteve

Zbatuar pjesërisht

3.1 Rekomandimi: Zyra e Shërbimeve Publike të marrë masa për pajisjen me autorizimet përkatëse të të gjithë subjekteve që operojnë në fushën e tregimit të hidrokarbureve dhe pas plotësimit të dosjeve përkatëse me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, të rakordojë me zyrën e Taksave dhe të Ardhurave Vendore për përlogaritjen dhe vjeljen e detyrimeve nga pajisja me autorizime

Nga verifikimi rezultoi se: Nga Zyra e Tërës Taksave, janë dërguar njoftimet për shlyerjen e detyrimit dhe pajisje me licence për 4 subjektet, konkretisht "Vëllezërit Tuci" shpk, "Londra" shpk, "Diezefta" shpk dhe "Keland" shpk, të cilat dërguara me datë 11.03.2024. Nga subjektet e mësipërme, rezultoi se vetëm me subjektin "Vëllezërit Tuci" shpk, është lidhur marrëveshje për pagesën e detyrimit të propambetur, si dhe likuidimin për vitin 2024 për pajisjen me autorizim për 1 vit. Sipas dokumenteve të lëshuara nga banka për pagesat e kryera, rezultoi se janë likuiduar nga ky subjekt 733,335 lekë, nga të cilat 533,335 lekë janë detyrime të propambetura dhe vlera 200,000 lekë është për pajisjen me 1 licencë për 1 vit. Lidhur me 3 subjektet tjera, për arsye të njoftimit nuk kanë filluar akoma veprimet për orkëstrimin e detyrimeve dhe pajisjen me licence.

Zbatuar pjesërisht

4.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz, si dhe drejtuesit e drejtorive dhe përgjegjësit e sektorëve, të marrë masa për hartimin dhe miratimin e strategjisë së menaxhimit të risqeve, me qëllim menaxhimin e riskut, ku të bëhet identifikimi, analiza, kontrolli dhe përditësimi 2 herë në vit i risqeve që mund të kenë efekt negativ në arritjen e objektivave të institucionit.

Nga verifikimi rezultoi se: *Mëson regjistri i riskut i institucionit, por rezultoi se nga drejtori/ sektore janë hartuar regjstrat e riskut për vitin 2024.*

Zbatuar pjesërisht

4.2.Rekomandimi: Përgjegjësi i Sektorit Juridik në bashkëpunim me Përgjegjësin e Sektorit të Burimeve Njerëzore të kryejë ndryshimet e nevojshme në rregullaren e brendshme të institucionit me qëllim përcaktimin e qartë të detyrave për çdo pozicion pune

Nga verifikimi rezultoi se: *Me urdhrin nr. 1445 prot , datë 17.01.2024 të Titullarit, është ngritur grupi i punës "Për përkthimin e rregullores së Bashkisë Fushë Arrëz" i përbërë nga 4 punonjës me detyra drejtuese të këshillatshme të cilët janë në proces të ndryshimeve të rregullores.*

Në proces zbatimi

4.3.Rekomandimi: Përgjegjësi i Sektorit të Burimeve Njerëzore të marrë masa për hartimin dhe zbatimin e programit të trajnimit të stafit të Bashkisë, me qëllim zhvillimin profesional të tyre, si dhe hartimin e hartës së proceseve të punës në Bashkinë Fushë Arrëz.

Nga verifikimi rezultoi se: *Javë administruar kërkesa nga personeli për trajnime për vitin 2024. Plani i trajnimeve përgjithësisht përfshin trajnimet që organizohen nga ASPA, ku janë përcaktuar edhe personat të cilët do ndjekin këto trajnime. Duhet të punohet me shumë që plani i trajnimeve të përfshijë dhe kategoritë të cilët rregullojnë mbi edukimin e punës sipas Kodit të Punës.*

Në proces zbatimi

5.1.Rekomandimi: Njësia e Auditimit të Brendshëm, Bashkia Fushë Arrëz, të marrë masa për të planifikuar dhe kryer auditime në fushat e veprimtarisë së institucionit që paraqesin risk të lart, si: Vlerësimi i sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm, prkurimet publike, administrimi i taksave dhe tarifave vendore, zbatimin e rekomandimeve etj. në mënyrë që t'i ofrojë mbështetje titullarit të njësive vendore në arritjen e objektivave.

Nga verifikimi rezultoi se: *Njësia e Auditit të Brendshëm në Bashkinë Fushë Arrëz, ka dërguar pranë Drejtorisë së Harmonizimit të Auditit të Brendshëm në Ministrinë e Financave planin vjetor 2024, dhe atë strategjik 2024 - 2026 sipas të cilit janë planifikuar për të audituar Sektorin e Financës, Sektorin e Të Ardhurave, Sektorin Juridik dhe i Prokurimeve si dhe zbatimi i rekomandimeve të këta. Lidhur me rekomandimet e këta, është bërë një program tematik në subjektet Drejtoria e Shërbimeve Publike, Sektorin e Planifikimit të Territorit, Sektorin e Rrugëve Rurale, Njësia Administrative Ishullë, Njësia Qafë Stadi për periudhën 01.01.2022 - 31.06.2023 Raporti Përfundimtar i të cilit është dërguar me shkresën nr. 144 prot , datë 17.01.2024.*

Në proces zbatimi

6.1.Rekomandimi: Përgjegjësi i Sektorit të Financës, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të të drejtave të Bashkisë për arkëtim nga të tretët, në llogarinë nr.468 "Debitore të ndryshëm" me kundërparti llogarinë nr. 470 "Të ardhura për t'u marrë".

Nga verifikimi rezultoi se: *Është bërë mbyllja e llogaritë 468 "Debitore të ndryshëm", duke kryer llogarinë 470 "Të ardhura për t'u marrë" në pasiv të bilancit. Konfirmuar me shkresën nr.*

Zbatuar

7.1.Rekomandimi: Përgjegjësi i Sektorit të Financës në bashkëpunim me Sektorin e Urbanistikës, të marrë masat e nevojshme për kontabilizimin e plotë dhe të saktë të llogaritë nr. 466 "Kreditorë për mjete nën ruajtje", si dhe të ofrojë subjektet për paraqitjen e dokumentacionit të nevojshëm për të likuiduar vlerën e garancisë, të cilave ju ka kaluar atë i përcaktuar në kontratë dhe investimi për të cilën është mbajtur garancia, është marrë në dorëzim

Nga verifikimi rezultoi se: *Për vitin 2023, llogaria 466 "Kreditorë për mjete nën ruajtje", është pajësuar në vlerën 56,681 lekë si rezultat i likuidimit të garancive 3% ndaj operatorëve të cilët*

kanë përmbushur afatin.

Në proces zbatimi

8.1.Rekomandimi: Njësitë e Prokurimit në Bashkinë Fushë Arrëz, të marrin masa për hartimin e kriterëve të kualifikimit në përputhje me natyrën dhe përmasën e kontratës, për të nxjerrë konkurrencën në mënyrë që të stimulojnë pjesëmarrjen e biznesit të vogël dhe të mesëm. Si dhe në çdo rast në përlogaritjen e fondit limit ti nënshtrohen njëzës nga mënyrat që parashikon ligji, si dhe për çdo rast të marrin masat për dokumentimin e tij me qëllim menjanimin e problematikave të krijuara dhe menaxhimin me efikasitet të fondeve publike.

Nga verifikimi rezultoi se: *U testuan 2 dasja, me për zgjedhje lidhur me verifikimin e dokumentacionit bashkëlidhur, konkretisht procedurat me objekt "Shërbim financiar me dru zjarri, dhe blerja peltet për institucionin e Bashkisë Fushë Arrës", dhe "Rindërtim i mureve obqetës të sheshëve të pallateve në qytetin Fushë Arrëz". Lidhur me hartimin dhe argumentimin e kriterëve të veçanta të kualifikimit, rezultoi se janë mbajtur procesverbalet përkatëse për secilën nga procedurat. Lidhur me përlogaritjen e fondit limit, procedura për punë publike ka projektin e dhënëuar i cili ka të përcaktuar vlerën e fondit, ndërsa për procedurat blerje/shërbim, janë mbajtur procesverbalet për përlogaritjen e fondit limit dhe analiza bashkëlidhur.*

Në proces zbatimi

9.1.Rekomandimi: Bashkia Fushë Arrëz, Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të marrin masa për kualifikimin vetëm të atyre OJ që plotësojnë kërkesat për kualifikim dhe në çdo rast për çdo paqartësi apo pasaktësi të kërkojnë sqarime shtesë nga OJ pjesëmarrës me qëllim përfundimin e punës/shërbimit apo mallit me cilësinë dhe çmimin më të mirë.

Nga verifikimi rezultoi se: *Procedurat e prokurimit dhe vlerësimit i ofertave i kryer nga KVO, do shqyrtohet gjatë auditimit të përputhshmërisë pranë këtij AK*

Në proces zbatimi

10.1.Rekomandimi: Sektori i Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Bashkia Fushë Arrëz, të marrin masa për shqyrtimin dhe miratimin e lejeve të ndërimit, ku të respektohet legjislacioni sektorial në fuqi, duke kryer bashkëveprimin me të gjitha institucionet e ngarkuara për dhënie mendimesh, përpara miratimit të lejes.

Nga verifikimi rezultoi se: *Nga informacioni i administruar nga Sektori i Planifikimit të Territorit, rezultoi se për vitin 2023 është miratuar 1 leje ndërtimi në infrastrukturë, konkretisht "Ndërtim luge të TBM për objektin "Fabrikë ambalazhimi uji të pijshëm". Sipas vendimit të lejes me nr. 5, datë 11.04.2023, pjesë e dokumentacionit është edhe miratimi për VNM paraprake, shqyrtimi me i detajuar i së cilës do vlerësohet gjatë auditimit të përputhshmërisë pranë kësaj bashkie.*

Në proces zbatimi

11.1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz, të marrë masa për krijimin dhe funksionimin e Inspektoratit Vendor të Mbrojtjes së Territorit jo vetëm si detyrim ligjor, por njëkohësisht për të bërë të mundur kontrollin e territorit në raport me ndërtime pa leje, si dhe verifikimin e ligjshmërisë së zbatimit të lejeve të miratuara.

Nga verifikimi rezultoi se: *Sipas Urdhrit nr. 313, datë 08.08.2023 "Për disa shëresa dhe ndryshime të urdhrit nr. 596, datë 19.12.2022 për miratimin e strukturës organizative të Bashkisë Fushë Arrëz.....". Sipas këtij urdhri është shpallur në organike edhe Inspektorati i Mbrojtjes së Territorit Vendor, i cili ka përcaktuar 3 pozicione pune nga të cilët 1 Kinspektor dhe 2 inspektor. Aktualisht, janë plotësuar të tre pozicionet e punës.*

Zbatuar

12.1 Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë Fushë Arrëz dhe komisioni i pranimi të përhershëm, në çdo rast të marrë masa për ndjekjen e procedurave të plota dhe të paanshme në plotësimin e vendeve vakante duke respektuar fazat e rekrutimit, publikimit të vendeve vakante dhe dhënien e mundësisë për ngritjen në detyrë e postaj rekrutimin rishtaz të stafit të Bashkisë Fushë Arrëz.

Nga verifikimi rezultoi se: Për përshkrimin objekt auditimi është ngritur komiteti i pranisë për ngritjen në detyrë, levizjen parave dhe konturimin nga fusha me nr. 257, datë 17.07.2023 dhe nr. 13.01.2024. Përgjithësisht në faqen e 66-b-it të bashkisë bëhen njoftimet për vende pune.

Në proces zbatimi

C.1.MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE FINANCIARE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE ME EKONOMICITET, EFICENCE DHE EFEKTIVITET.

1.Rekomandimi: Kryetari i Bashkisë në bashkëpunim me Njësinë e Butimeve Njerezore, të marrin masa për vlerësime dhe vendimmarrje korrekte në rastet e largimeve nga puna të punonjësve, duke argumentuar në çdo rast shkeljet e konstatuara, si dhe ndjekjen me përpikëri të çdo laze që parashikon kadhë ligjor përpara vendimmarrjes finale për shkarkimin e punonjësit.

Nga verifikimi rezultoi se: Referuar Bilancit të vitit 2023, nuk ka asnjë detyrim të propambetur, duke u kryer të gjitha likuidimet. Nuk ka asnjë proces të ri gjyqësor për largime nga puna

Zbatuar

2.1.Rekomandimi: Njësitë e Prokurimit në Bashkinë Fushë Arrëz, të marrin masa që në çdo rast në përfundim të fundit limit të nënshtrohen njërit nga mënyrat që parashikon ligji, si dhe për çdo rast të marrin masa për dokumentimin e tij me qëllim menaxhimin e problematikave të krijuara dhe menaxhimin me efikasitet të fondeve publike.

Nga verifikimi rezultoi se: Sipas urdhrit nr. 357, datë 06.09.2023 është urdhëruar ushja e procedurës me objekt "Shërbim furnizim me dru zjarri dhe blerje pajisjesh për institucionin e Bashkisë Fushë Arrëz. Sa me shpejt, rezultoi se Bashkia Fushë Arrëz, ka aplikuar shërbimin dhe jo blerjen e druve të zjarrit. Lidhur me këtë procedurë, është lidhur kontrata përkatëse me OF fitues.

Zbatuar

C.2.MASA PËR ARKËTIMIN E TË ARDHURAVE TË MUNGUARA

1.1.Rekomandimi: Zyra e Taksave dhe Tarifave vendore të marrin masa për ndjekjen e të gjithë detyrimeve sipas legjislacionit dhe pakotave fiskale të miratuar si dhe vëlljen e detyrimit të krijuar nga subjektet që tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënpivekule të tyre.

Nga verifikimi rezultoi se: Nga verifikimi, rezultoi se nga 4 subjektet të cilat tregtojnë me pakicë hidrokarbure dhe nënpivekule të tyre, në 2 raste ndënpivekulej dosje e subjekteve dhe konkretisht "Vëllezërit Tuci" shpk, "Lonola" shpk dhe Alfred Ndoci 1990 shpk. Subjekti "Vëllezërit Tuci" ka lidhur marrëveshje duke filluar edhe likuidimin e detyrimeve të propambetura si dhe pagesën për 1 vit për pagesën me llogaritë. Subjekti "Lonola" shpk dhe Alfred Ndoci 1990 shpk rezultoi se kanë parashitë kërkesa drejtuar Bashkisë Fushë Arrëz, të administruara me nr. 1121 prot., datë 15.04.2024 dhe nr. 1506 prot. datë 09.03.2024, ku kërkohej parimisht likuidimi i pagesave me kështë duke lidhur akt marrëveshjeje. e cila rezultoi se nuk është formalizuar akoma. Për subjektin Keli Oil shpk, nuk disponohet dosje si dhe rezultoi delitor pranë Bashkisë Fushë Arrëz për licencën e tregtimit me pakicë të karburanteve. Subjekti Dizela, rezultoi se nuk ushtron as aktivitet për tregtimin e karburanteve në Bashkinë Fushë Arrëz pasi këtë adresë aktualisht e ka subjekti Alfred Ndoci 1990 shpk. por Bashkia Fushë Arrëz nuk ka kryer veprimet për të bërë të mundur likuidimin e detyrimeve të miratuar nga subjekti Dizela shpk për licencën e tregtimit me pakicë, për të cilën kërkohej të bëhet njoftimi i këtij subjekti, deri në ndjekjen e të gjitha rrethjeve administrative për të bërë të mundur arkëtimin në vlerën 1.000,000 lekë nga ky subjekti.

Zbatuar pjesërisht

